

NDIEJ

shushurimën

MIKUN

nuk e shoh



HASAN EL-BASRI

NDIEJ SHUSHULLIMËN, MIKUN NUK E SHOH

tregime për moralin (ahlakun)
rregullat e sjelljes islame,
devotshmërinë dhe të tjera

Edukata dhe vlerat morale

Më shumë dëshiroj t'i ndihmoj vëllait në fe, kur i nevojitet ndihma ime, se sa të tërhiqem në xhami një muaj ditë duke bërë ibadet.

Bujaria, mëshira dhe durimi janë virtyte të njeriut të edukuar mirë.

Njerëzorja shihet në singëritetin ndaj të tjerëve, afrimin ndihmë vëllezërve nga feja, në mirëbërjen dhe largimin e vështirësive nga fqinjët e afërm.

Po të dëshironte All-llahu xh.sh., të gjithëve do t'ju bënte ose të pasur ose të varfër. Por, Ai dëshiroi t'ju sprovtojë, kështuqë disa i bëri të pasur, e disa i la në varfëri, por të gjithëve ua tregoi rrugën e të mirave, duke thënë: *"...ata u jepnin përparësi atyre para vetes. Ai që është ruajtur nga lakmia e vet, ata janë të shpëtuar"*. (Kur'an, 59-9).

Njeriu bujar nxiton që sa më parë të bëjë vepra të mira, ndërsa i keqi hiqet zvarrë në kryerjen bëmirësisë dhe shmanget nga ajo.

Nuk është i drejtë ai që kërkon ta nderosh, ndërsa nuk ta afron ndihmën e vet.

Ne i kemi konsideruar si koprracë të gjithë ata që kanë dashur t'i huazojnë vëllait të vet në fe, sepse ne i kemi ndihmuar njëri-tjetrit. Vëllai i ka dëshiruar vëllait më shumë se vetvetes. Pasha All-llahun, kam parë si muslimani e ndanë në dy pjesë mbulesën e vet që t'i ndihmojë atij që nuk e ka. Ndërsa tjetri agjëronte një ditë dhe kur vinte koha e iftarit, shkonte te vëllai sipas fesë dhe i thoshte: "Unë sot kam agjëruar në emër të All-llahut xh.sh. Dëshiroj që edhe ti të jeshë pjesmarrës në këtë të mirë, andaj më ofro diçka me çka do ta përfundoj agjërimin tim!" Dhe ai i jepte një gotë ujë apo grusht hurmash, që All-llahu xh.sh. ta shpërblejë baskë me agjëruesin.

E mbaj mend kohën kur njeriu kujdesej për familjen e vëllait të vet që kishte ndërruar jetë edhe pas dyzet vjetësh.

E mbaj mend kohën kur njerëzit i kanë urdhëruar të afërmit që të mos e refuzojnë e lënë të dëshpëruar asnjë nevojtar.

Nuk është mëkat të hashë dhe të pish në shtëpinë e mikut tënd edhe para se të të ofrojë vetë ai.

Njeriu do të pyetet për çdo gjë që harxhon, si dhe për harxhimet që i ka bërë për prindërit e vet. Mirëpo, nuk do të pyetet për harxhimet që i ka bërë për vëllain në fe dhe për përlujt tjera ndaj All-llahut xh.sh., sepse Atij i vjen turp ta pyesë për atë që e ka harxhuar për këto çëllime.

Nuk është e njerëzishme që njeriu të fitojë në kurriz të vëllait të vet.

Ruaju nga ai i cili i përcjellë fjalët e huaja, sepse edhe tuat do t'ia përcjellë dikujt tjetër.

Njeri, njeri! Kujdesu për veprat tua! Përsëri: Kujdesu për veprat tua! Ki kujdes se në çfarë gjendje do të takohesh me Krijuesin tënd!

Bamirësit njihen sipas sinqeritetit në të folur, ruajtjes së amanetit, kryerjes së obligimit, modestisë, vizitës së të afërmeve, mëshirës ndaj të dobtëve, bamirësisë, sjelljes dhe edukatës së mirë, shpërndarjes së diturisë dhe shoqërimit e qëndrimit të rrallë me gratë (e huaja).

Ruaju nga ndalimet e All-llahut xh.sh., do të jeshë i devotshëm! Bëhu i kënaqur me atë që ta ka dhënë All-llahu xh.sh., do të jeshë i pasur!

Bëhu fq i mirë, do të jeshë besimtar! Dëshiroju njerëzve atë që e dëshiron për vete, do të bëhesh i drejtë! Mos qesh shumë sepse kjo ta dëmton zemrën dhe tërë trupin!

Njerëz, derisa t'u nënshtroheni lakmive trupore nuk do ta arrini atë që e dëshironi, ndërsa derisa të mos i duroni sprovat, nuk do t'i realizoni shpresat.

Durimi është thesar i Xhennetit. Njeriu mund të arrijë shumë të mira po që se bëhet i durueshëm së paku për një çast.

Kush e ka arritur shkallën e kënaqësisë, nuk i nevojitet furnizim tjetër. Kush është i kënaqur, i përballon të gjitha sprovat.

Në prani të Hasanit u grindën dy persona e njëri prej tyre e fyu rëndë tjetrin. Duke i fshirë djersët nga balli, ky i citoi fjalët e All-llahut xh.sh.: “Kush bën durim dhe fal, s’ka dyshim se ajo është virtyti më i lartë (i lavdishëm). (Kur’an 42:43).

Në këtë Hasani tha:

-Pasha All-llahun, sa i mençur është, në kohën kur të padijshmit arsyen e shkatërruan.

Njerëz, ose do të stoliseni me durim, ose do të shkatërroheni!

Dikush duke e nënçmuar Ebu Dherrin r.a. e fyeu, ndërsa ai u përgjigj: “Ndërmjet meje dhe Xhehennemit ekziston një pengesë të cilën nëse e mposhti atëherë jam më i mirë se që thua, e nëse nuk mund ta kaloj, por përmysem në Xhehennem, atëherë me të vërtetë jam më i keq se që ke thënë ti”. Duro, njeri, sepse ti shkon tek Ai “i cili di për shikimin me cep të syrit në atë që është e ndaluar si dhe për atë që e fshehin në zemër”. (Kur’an, 40:19).

Dikush e shau dikë tjetër e ky i tha: “Sikur të mos ndiente All-llahu xh.sh., unë do ta ktheja (sharjen)”.

Ekzistojnë dy durime: durimi në fatkeqësi dhe durimi nga mëkatet. Kush duron atëherë, vërtet është i durueshëm.

Vërtet All-llahut xh.sh. i pëlqen ajo përpimje të cilën njeriu e kapërdinë si ngushëllim dhe durim kur i ndodhë një fatkeqësi e madhe, si dhe përpimja e hidhërimit të cilën e kapërdinë duke bërë mirë, duke falur dhe duke treguar mëshirë.

Njeri! Kurrë nuk mund t’i bashkosh besimin dhe tradhtinë. Si mund të jeshë besimtar kur fqiu nuk është i qetë prej teje? E si do të jeshë musliman nëse prej teje nuk janë të qetë njerëzit tjerë?! A nuk ka thënë i dërguari I All-llahut, a.s.: “Nuk ka besim ai, të cilit nuk i besohet, e as fe ai i cili nuk i plotëson premtimet”. Ai poashtu ka

thënë: “Nuk është besimtar ai nga e keqja e të cilit frikësohet fqiu i tij”.

Njeri! Nuk je në besimin e vërtetë përderisa ua zbulon të metat të tjerëve, ndërsa vetë nuk je pa to. Andaj së pari largoi të metat tua, e lëri të tjerët dhe të metat e tyre. Por, dije se kurrë nuk do të mund t’i largosh të gjitha të metat tua, andaj është më me rëndësi t’u përkushtohesh dhe të merresh me to. Nëse dëshiron të jeshë i drejtë, atëherë mos i hulumto të metat e të tjerëve, kështu që edhe për All-llahun xh.sh. do të jeshë i dashur dhe i këndshëm.

Njeri! Sa i dobët dhe i pakujdesshëm që je! Të tjerëve ua zbulon mëkatet, ndërsa mëkatet tua i lë pas dore dhe i harron. Në sytë e vëllait e sheh edhe të metën më të vogël, e në syrin tënd nuk e sheh a trarin. Sa e vogël është drejtësia yte, ndërsa sa e madhe padrejtësia!

I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., ka thënë: “Bamirësit e kësaj bote do të jenë bamirës edhe në botën tjetër, sepse atyre All-llahu xh.sh. do t’ua falë gabimet për të mirat që ua kanë bërë krijesave të Tij. Në Ditën e Gjykimit do t’u thuhet: “Veprat tuaja të mira dhurojani kujt të dëshironi, sepse ua kemi falër veprat tuaja të këqija”. Dhe ata do t’i dhurojnë të mirat e veta dhe ashtu përsëri do të bëhen bamirës”.

Fisnikëria dhe sinqeriteti janë vetitë më të mira.

Xhiahadi më i mirë është ai që zhvillohet kundër epsheve (lakmive) personale.

I mbaj mend njerëzit të cilët në dinarin dhe dirhemin e vet nuk i kanë dhënë vetes më shumë të drejtë se vëllait në fe. Po ç’është me ju, o njerëz; bëni koprraci në atë për çka modeomos do të jepni llogari!?

Nuk ka fe ai që nuk ka njerëzi.

Kush e mban drithin dyzet ditë duke pritur që t’i rritet çmimi, nuk do të mund të shpëtojë nga mëkatet edhe nëse më vonë e bluan personalisht, gatuan bukë dhe me të i ushqen të varfërit.

All-llahu xh.sh. do ta ruajë nga djalli dhe Xhehennemi njeriun te i cili gjinden këto katër veti: përmbajtja në frikë, nxitim, hidhërim dhe lakmi.

Dituria është më e mirë se trashëgimi, edukata është fytyra më e pastër; devotshmëria është furnizimi më i sigurt; ibadeti është fitimi më i mirë, mendja është udhërrëfyesi më i mirë; sjellja e mirë është shoku më i mirë, butësia është ndihmësi më i mirë; kënaqësia është pasuria më e madhe; ndihma e All-llahut është ndihma më e mirë; ndërsa përkujtimi i vdekjes është predikuesi më i mirë.

Mos u bën si ai që e grumbullon diturinë e të diturve dhe mençurinë e të mençurve, ndërsa ndaj të Vërtetës sillet si i marrë.

All-llahu xh.sh. do ta fusë në Xhennet dhe do ta mbulojë me mëshirën e vet njeriun i cili sillet mirë ndaj prindërve, që është i mëshirshëm ndaj të shtypurve, i kujdesshëm ndaj bonjakut dhe mbrojtës i të paaftëve.

I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., ka thënë: "Dituritë janë dy llojesh: dituria në zemër, e cila është e dobishme, dhe dituria në gjuhë, e cila në të vërtetë është argument i All-llahut xh.sh. kundër njeriut.

Xhelozia e prishë fenë më shpejtë se zgjerimi i zgjebes nëpër trup.

Besimtari i mençur dhe mendjemprehtë e shton frikën e vet ndaj dënimit të All-llahut xh.sh. sa herë që All-llahu i lartmadhëruar ia shton të mirat.

Besimtari është punëdashësi më i madh dhe ai i frikohet vetëm All-llahut xh.sh. Sikur ai të shpenzonte në rrugë të All-llahut ar sa Kodra e Uhudit, përsëri s'do të ishte i sigurt se ka shpëtuar. Ai këtë e përsërit përderisa nuk dëshmohej në shpëtim: "Kurrë, vërtet kurrë, nuk do të shpëtoj"!

Ndërsa dyfytyrëshi thotë: "Sa shumë njerëz të thjeshtë që ka! Ç'janë mëkatet e mia ndaj mëkateve të tyre?! All-llahu është i mëshirshëm dhe fal shumë e do t'mi falë edhe mëkatet e mia".

Njeri, pse po flet ashtu? Bën vepra të këqia duke u mashtruar me shpresa të kota për falje (nga All-llahu xh.sh.).

Kush ka edukatë të keqe, e ka dënuar veten.

Kush ka pasuri të madhe, ka mëkate të mëdha.

Kush flet shumë, shpesh gabon.

Po të mos ishte dituria, njerëzit do të ishin si kafshët.

Umer ibn el-Hatabi r.a. ka thënë: “Jep selam i pari kur të takohesh me vëllain në fe, thirrë me emrin që ai e pëlqen më shumë dhe bëja vendin në ndejë, se kjo do t’ia shtojë dashurinë ndaj teje”.

Paraardhësit tuaj janë shembull për ju në edukatën e mirë. Merrni këshillë, All-llahu ju mëshiroftë!

Mos u bëni cikërrimtarë e të bëhet edhe All-llahu xh.sh. cikërrimtar ndaj jush! Mallkimi i All-llahut është mbi njeriun cikërrimtar si dhe mbi atë që është cikërrimtar për cikërrimtarin!

Ç’ndodhë kjo me ne? E takojmë njëri-tjetrin dhe themi: “Le të na i falë All-llahu xh.sh. mëkatet dhe le të na shtiejë në Xhennet”! Por, kur janë në pyetje dinari e dirhemi, çdo gjë ndryshon. Të mjerët ju! Kështu nuk kanë vepruar paraardhësit tuaj të mirë. Pse nuk i merrni ata si shembull, siç jeni të urdhëruar?!

Njerëz, ç’është kjo me ne?! Kur kemi bollëk, njëri-tjerit i jemi të afërt e të dashur, ndërsa posa të biem në sprova, e harrojmë njëri-tjetrin. Nuk kanë qenë të tillë shokët e të dërguarit të All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ruana o Zot, se mos veprojmë ndryshe prej tyre!

Vëlla, ki kujdes se ç’flet! A nuk është thënë se është më së miri që gjuhën ta mbash gjithnjë të lidhur? I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., ka thënë: “A thua njerëzit do të hidhen në Xhehennem për diç tjetër pos për të folurit e gabuar?!”

Te njeriu i mençur gjuha është pas zemrës dhe kur dëshiron të thotë diçka, së pari mendon mirë. Nëse thënia e tij do të jetë e dobishme, atëherë e thotë, në të kundërtën heshtë. Ndërkaq te i

padituri zemra është pas gjuhës. Ai flet sa herë që do duke mos menduar fare.

I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., ka thënë: “Pasardhësit e mi do të hyjnë në Xhennet me mëshirën e All-llahut xh.sh., me pastërtinë e zemrës dhe për mëshirën që e kanë ndier ndaj të gjithë muslimanëve, e nuk do të hyjnë vetëm për shkak namazit e agjërimit të shumtë”.

Thuhet se, kur do të ndodhë Dita e Gjykimit, lajmëtari do të thërrasë: “Le të ngrihet tash ai, për të cilin All-llahu i madhëruar e ka marrë si obligim se do ta shpërblejë prej Vetes”! Dhe atëherë do të ngrihet vetëm ai që i ka ndihmuar vëllait të vet nevojtar, apo i cili ia ka falër vëllait të vet padrejtësinë e bërë, ose i cili vëllait të vet i ka dhuruar diç nga të mirat me të cilat e ka shpërblyer All-llahu xh.sh..

Njeriu i mençur nuk e shpengon armiqësinë e një njeriu për dashurinë e një mijë të tjerëve. Kush e bën këtë, do t’i humbë të gjitha dhe do të mbetet pa asgjë.

Madhëria e njeriut fisnik është edukata e tij, ndërsa devotshmëria e singertë është prejardhja e tij.

Kush e fajëson vëllain e vet për mëkatin për të cilin është penduar te All-llahu xh.sh., nuk do të vdesë përderisa nuk vihet në të njëjtën sprovë.

Kur Rebia ibn Subha e ka pyetur Hasanin se a janë sunnet ose nafile dhjetë rekatet që ai i falte rregullisht pas jacisë, ai është përgjigjur:

- Nuk janë sunnet, sepse po të ishin sunnet muslimani nuk do t’i linte (pa i falur). Por, o djali i vëllait tim, në sjelljen e mirë të muslimanit dhe në plotësimin e fesë së tij hyn edhe kjo: Kur veten e mëson në kryerjen e një të mire dhe atë e kryen rregullisht, apo kur e mëson një ibadet ndaj All-llahut xh.sh., duhet që në atë të jete i qëndrueshëm vazhdimisht.

Në Teurat thuhet: “Pasuria e vërtetë është në kënaqësinë, shpëtimi në vetmi, shëndeti në largimin e lakmive, qetësia në

mospasjen e dëshirave, ndërsa kënaqësia e vërtetë është në amshimin që fitohet me durimin në këtë botë të shkurtër”.

Njerëz, stolisuni me vetitë që i porositë All-llahu xh.sh. dhe kini kujdesë ndaj urdhrave të Tij, kështu që do të jeni miq të All-llahut.

Askujt përveç Sulejmanit a.s. nuk i është dhënë asnjë e mirë për të cilën nuk do të përgjigjet. Sulejmanit a.s. i është thënë: “Ky është shpërblimi Ynë, e ti dhuro ose mos dhuro, për këtë nuk përgjigjesh”. (Kur’an, 38:39).

Kush është i sigurt në kompensim, është zemërgjërë në dhënie.

Ti o njeri, je i përbërë prej pjesëve. Dhe sa herë që kalon një ditë, shkon edhe një pjesë ytja.

All-llahu xh.sh. e ka mëshiruar Ibni Mes’udin i cili sikur t’ju ketë pasur parasysh kur ka thënë: “Zahidi juaj (ai i cili përmbahet nga të mirat e kësaj bote) në të vërtetë është lakmues i kësaj bote, muxhahidi juaj (luftëtari në rrugë të All-llahut) është mospërfillës, ndërsa alimi juaj është më i paditur i vërtetë”.

Ai që i frikësohet vetëm All-llahut xh.sh., All-llahu xh.sh. bën që t’i frikësohen të gjithë të tjerët, ndërsa ai që i frikësohet botës, All-llahu bën që ai t’i frikësohet çdo gjëje.

Omer ibn el-Hattabi, radijall-llahu anhu, ka thënë: “Shoqërohuni dhe shmangiuni shoqërimit; që do të thotë: bëhuni shokë në vepra të mira, ndërsa largohuni nga njerëzit në punë të këqija.

Muslimani i ka borxh muslimanit: T’i ndihmojë mirëbërësit, t’i përgjigjet atij që e thërret, të kërkojë falje për mëkatin dhe ta udhëzojë në të vërtetën atë që e kërkon të vërtetën.

Atij që e largon nga vëllai i vet musliman ndonjë të keqe ose ia plotëson ndonjë nevojë, do t’i falen mëkatet (e vogla) të mëparshme.

Transmetohet se All-llahu i Madhëruar i ka thënë Ademit a.s.: “O Adem, në katër gjëra është përfshirë çdo gjë që ka të bëjë me ty

dhe me pasardhësit tu. Njëra prej tyre është për Mua, njëra është për ty, njëra është ndërmjet Meje dhe teje, ndërsa njëra ndërmjet teje dhe njerëzve. E Imja është: vetëm Mua të më përulesh dhe të mos ma konsiderosh askënd të barabartë. E jotja është: të punosh, ndërsa Unë, nëse punon, do të të shpërblej atë Ditë kur shpërblimi Im do të të nevojitet më së shumti. Ndërmjet Meje dhe teje është: ti të më drejtohesh me lutje, ndërsa Imja është që ta plotësoj. Ndërsa ndërmjet teje dhe njerëzve të tjerë është: miqësohu dhe shoqërohu me njerëz për atë që dëshiron që edhe ata të shoqërohen me ty”.

Të kuptuarit është sikur ena në të cilën ruhet dituria. Dituria të drejton kah vepra, ndërsa vepra të dërgon në punë të mirë.

Epshi të çon në mëkat. Pasuria është sëmundje e mendjelartëve. Kjo botë është treg në të cilin fitohet bota tjetër.

Mjerë dhe mjerë për çdonjërin i cili të mirat e All-llahut i harxhon në mëkate ndaj Tij!

Njeri! Besimi nuk do të thotë që ti të tregohesh para njerëzve se je besimtar, përderisa mashtrohesh me dëshira të kota. Besimi i vërtetë është ai i cili është skalitur thellë në zemër dhe të cilin e vërtetojnë veprat e mira të njeriut.

Kur Hasanin e lajmëruan për vdekjen e Davud et-Taijjut, rahime-hullah, ai tha: “Le t’ia falë All-llahu mëkatet! Pasha All-llahun, ka qenë si shëndeti, vlerën e të cilit e kuptojmë atëherë kur e humbim”.

Kërkoni diturinë, që ta kuptoni fenë. Merruni me mjekësinë që ta njoftoni trupin. Mësoni dituritë gramatikore që të folurit tuaj të jetë sa më i drejtë.

Kush lexon Kur’anin gabimisht, thotë gënjeshtër për All-llahun xh.sh.. Në Kur’an thuhet: “...ndërsa Kur’ani është libër i mbrojtur, atij nuk mund t’i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit”. (Kur’an, 41:41-42). Leximi i gabuar i Kur’anit është i barabartë me gënjeshtërën më të madhe.

Mos u bë lakmitar, nuk do të poshtërohesh.

Mos kërkohet prej njerëzve, nuk do të pakësohet (pasuria), ndërsa ti do të mbetesh njeri.

Nëse nuk je i butë, tregohu i butë.

Nëse nuk je i ditur, përpiku të mësosh.

Njeriu kryesisht është si ai me të cilin shoqërohet.

Njeri i përkryer është ai te i cili gjenden këto katër vlera:

- Besimi që e udhëzon;
- Mendja pas të cilës shkon;
- Prejardhja bujare e cila e ruan
- Turpi i cili ia mbron dinjitetin.

Njeriu te i cili hasen madje njëra nga këto vlera, te populli i vet, është në mesin e të zgjedhurve.

Kujt t'i ankohet muslimani nëse jo vëllait të vet?! Sepse, kujt i dhemb ajo që i dhemb atij, nëse jo vëllait të tij në fe?!

Muslimani është pasqyrë e muslimanit: përmes tij ai i vëren të metat e veta dhe i sheh gabimet. Më parë kur muslimani e takonte vëllain e vet i thoshte: "Vëllai im, unë nuk mund t'i shoh e as t'i di të gjitha mëkatet e mia. Andaj, nëse në diçka e sheh të mirën, më urdhëro që ta punoj, ndërsa më ndalo nga e keqja! Umer ibn el-Hattabi, radijall-llahu anhu, ka thënë: "All-llahu e ka mëshiruar çdonjërin që na i bën me dije veprat tona të këqija"! Ata që ishin para jush i kanë pranuar këshillat e njëri-tjetrit dhe ashtu janë ndihmuar mes vete.

Besimtarët janë një: kur besimtarin e godet ndonjë brengë, kjo i brengosë edhe besimtarët tjerë; kur gëzohet besimtari, edhe besimtarët tjerë janë të gëzuar.

Ti nga miku dhe shoku yt ke pjesë të përgjegjësisë nga shoqërimi me të, andaj zgjedhi vetes shok dhe mik të vërtetë. Ndërsa për shoqëri të keqe do të përgjigjesh!

Njeri, bëhu tejet i kujdesshëm sepse njeriu shpesh e merr ushqimin të cilin nuk e ka të lejuar, shkon atje ku nuk e ka vendin dhe ulet në shoqëri e cila e ndryshon dhe kështu, pak nga pak, shkon feja e tij e ai as që e vëren.

Shenjë që dikush kërkon dituri në emër të All-llahut xh.sh. janë pendimi, devotshmëria dhe modestia e tij.

Përpikuni të jeni të pranishëm gjatë ceremonive të xhenazes, sepse në këtë është shpërblimi për atë që është durimtar në atë që i ka ndodhur, atij që e ka falur xhenazen dhe atij që e mbulon të vdekurin me dhe. Kush pret derisa të varroset i vdekuri, do t'i falen shtatëdhjetë mëkate të mëdha.

O njerëz, kini kujdesë nga zvarritja në punë sepse e kam dëgjuar njërin ndër njerëzit e mirë që thoshte: “Ne nuk dëshirojmë të vdesim para se të pendohemi, ndërsa vdesim pa u penduar”.

Gjatë marrjes të ushqimit janë dymbëdhjetë veti të mira prej të cilave katër janë të obligueshme, katër sunnet dhe katër veti të lavdëruara. Të obligueshme janë:

-të thuhet **Bismil-lahir-rahmanir-rahim** (Në emër të All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit),

-ta konsiderosh ushqimin si të mirë,

-të kënaqesh me atë që e ke dhe

-të falënderosh për atë të mirë.

Sunnet janë:

-të ulesh në këmbë të djathtë,

-të hash para vetes,

-të hash me tre gishtërinjtë e dorës së djathtë dhe

-t'i lëpish gishtërinjtë në fund.

Ndërsa veti të mira janë:

-t'i pastrosh duart para dhe pas ushqimit,

- ta zvogëlosh kafshatën,
- ta përtypësh mirë kafshatën dhe
- të mos shikosh në fytyrat e të pranishmëve gjatë ngrënies.

Gjëja më e vlefshme është fitimi i lejuar sipas sheriatit dhe vëllai në fe i cili, nëse konsultohesh me të për punët e kësaj bote, bindesh në mendimin e drejtë të tij, ndërsa poqë se konsultohesh për gjërat që kanë të bëjnë me besimin, bindesh se me të vërtetë është i ditur për to.

Njeriu mund të jetë i ditur e të mos jetë i devotshëm, ndërsa mund të jetë i devotshëm e të mos jetë i ditur. Por, Muslim ibn Jesari ka qenë edhe i devotshëm edhe i ditur, edhe i urtë.

Sa bujar ka qenë Bekr ibn Abdull-llahu! E kam dëgjuar njëherë se si urdhëronte të jemi shpirtgjerë dhe si nxiste në falje (gabimesh) duke thënë: “O njerëz, shuani hidhërimin tuaj duke e përkujtuar flakën e Xhehennemit”! Ndërsa Ebu Derdaja ka thënë: “Derisa është i hidhëruar, njeriu është më afër hidhërimit të All-llahut”.

Kush është stolisur me mendje të shëndoshë, ka shpëtuar nga dështimi.

Sillu mirë me njerëzit, sepse qëndrimi në mesin e tyre është i shkurtër.

Dy gjëra kurrë nuk shkojnë së bashku: kënaqësia dhe xhelozia.

Njeriu udhëheq me mendjen, fisnikërinë dhe bujarinë.

Mos i shko askujt përveç atij, të mirës së të cilit i shpreson, nga pushteti i të cilit nuk frikësohesh, mëshirën e të cilit e pret dhe me dijeninë e të cilit mund të stolisesh.

Thënie dhe këshilla të urta

Kur e ka dëgjuar njërin se si mallkon: O Zot, shkatërroi mëkatarët, Hasani ka thënë:

- Atëherë do të ndjehemi të vetmuar në rrugë dhe do të zvogëlohet numri i atyre që veprojnë sipas dëshirës së vet.

Feja jonë është e fortë, ndërsa e vërteta është e rëndë. Njeriu është i dobët dhe i pafuqishëm; prandaj le të ngarkohet aq sa mund të bartë. Sepse nëse mbingarkohet me detyra të shumta, ekziston frika nga pritesa dhe braktisja e punëve.

Sëmundja e pastron trupin siç e pastron zekati pasurinë.

Trupi që nuk di për sëmundje është sikur pasuria që nuk pastrohet me zekat: në të nuk ka përparim.

Mendimi i drejtë dhe devotshmëria janë veprat më të mira. Kush e rregullon jetën e vet sipas tyre, është i sigurt se do të shpëtojë. Çdokush tjetër le ta vështrojë me kujdes jetën e vet. Mendimi i drejtë është sikur pasqyra në të cilën ndahen veprat e mira nga të këqijat. Kush mbështetet në mendimin e drejtë do të shpëtojë, ndërsa ai që e lë pas dore, do të dështojë. Po të mos ishte harresa, do të shtoheshin fakihët (juristët).

Njeriu i quajtur Eban tregon:

"Kam hyrë në xhaminë ku e takova Hasanin. Kur e pyeta se a është falur, tha se ende nuk ishte falur.

-Por në çarshi janë falur?!" - i thash.

-Kush e merr fenë nga çarshia?! Nëse u shkon tregtia mirë, e lënë faljen e namazit për më vonë, ndërsa nëse nuk u shkon për dore, falen para kohës së namazit!"

Ruaju nga tri gjëra, do t'ia ndalosh shejtanit praninë (rrugën):

-Kurrë mos qëndro vetëm me gruan e huaj, edhe nëse thua se ia mëson Kur'anin;

-Assesi mos shko tek sunduesi edhe nëse thua se e mëson për bamirësi, ndërsa e ndalon të bëjë keq dhe

-mos u ul me bidatçiun¹, sepse do të vejë helm në zemrën tënde dhe ashtu do të ta prishë fenë.

Kërko kënaqësi në tri gjëra: në namaz, në leximin dhe kuptimin e Kur'anit dhe në dhikr. Nëse në këto gjen kënaqësi, gëzohu! Në të kundërtën, dije se dyert tua janë të mbyllura, andaj mundohu t'i hapish!

Po të mos ishin vdekja, sëmundja dhe varfëria njeriu kurrë nuk do të përkulej, sepse edhe përkundër këtyre tri gjërave ai është i padurueshëm.

Njerëz, pasha All-llahun ne jemi të krijuar për amshim, e jo për të përkohshmen. Ne vetëm shpërngulemi prej shtëpisë në shtëpi.

Ai që e nderon dhe e lavdëron bidatçiun, është i shpejtë në rrëzimin e Islamit.

I Dërguari i All-llahut, s.a.v.s, ka thënë: "All-llahu xh.sh. hidhërohet me atë që e lavdëron mëkatarin".

Ruajuni të devotshmit i cili është i paditur dhe të diturit i cili është mëkatar, ata janë sprovë e madhe për secilin.

Njeri, mos u mashtro me thënien se njeriu është me atë që e do. Nuk do të jeshë me mirëbërësit përderisa të mos punosh si ata.

Ky popull do të jetë në të mira dhe nën mbrojtjen e All-llahut xh.sh. derisa të mirët të mos jenë të mëshirshëm ndaj keqbërësve, derisa mirëbërësit nuk i madhërojnë të shfrenuarit dhe derisa të diturit nuk pretendojnë të jenë udhëheqës. Por, kur të ndodhë e kundërta, All-llahu xh.sh. do ta largojë mëshirën dhe mbrojtjen e vet nga ai popull. Do t'ua ngarkojë në qafë keqbërësit të cilët do t'i vëjë

¹ Bidatçi është njeriu që fut risi në fe.

në tortura të rënda. Ndërsa dënimi i All-llahut xh.sh. do të shkaktojë ligështinë në zemrat e tyre.

Hasan Basriu e ka parë Neim ibn Ridvanin duke ecur kryelartë, andaj ka thënë:

Shikoni këtë: Në secilën pjesë të trupit i shihen të mirat e All-llahut xh.sh. por edhe mallkimi i shejtanit.

All-llahu xh.sh. do t'i pyesë besimtarët në Ditën e Gjykimit për të gjitha dhuratat dhe të mirat e veta, ndërsa jobesimtarët do t'i dënojnë ashpër, por me të drejtë.

Sa çudi është si përshkruajnë gjuhët, njoftojnë zemrat, ndërsa veprat dallohen prej tyre!

Kush merret me punë të dyshimta, nuk do të ketë shpërblim për atë që e përgojnë.

Kush dëshiron të dijë se në çfarë shkalle gjendet, le t'i krahasojë veprat e veta me Kur'anin, e do të shohë se çka fiton e çka humb. All-llahu xh.sh. e ka mëshiruar njeriun që i krahason veprat e veta me Kur'anin dhe kur e sheh se ato i përputhen me të, e falënderon All-llahun e Lartmadhëruar dhe i lutet për sukses më të madh. Por nëse e sheh se veprat i ka në kundërshtim me mësimet e kur'anore, pendohet dhe përpiqet që t'i përshtasë.

Dy roje dhe përcjellës kurrë nuk e lënë vetë.

Gjuha e tij i është laps, ndërsa pështyma e tij i është patron ngjyrë. E ai përsëri flet e atë që nuk i përket!

Sa i çuditshëm është njeriu!

Njeri, dëshiron të përmenden veprat tua të mira, ndërsa urren të dëgjohen veprat tua të këqija! E akuzon tjetrin për shkak të dyshimit, e sigurisht e di se dy melaqe janë të obliguara për veprat dhe fjalët tua.

I mençuri përpiqet që ditë e natë të bëjë sa më shumë vepra të mira, sepse në shpirtin e tij është frika se ndoshta Krijuesi i tij nuk do ta mëshirojë. Shumica kanë dështuar sepse kanë qenë të lavdëruar. Shumica kanë qenë të mashtuar sepse ndaj tyre kanë qenë

zemërmirë. Ruajuni lavdërimin sepse ai është vetëvrasje. Njërin e kanë lavdëruar në praninë e Të Dërguarit të All-Ilahut, salallahu alejhi ve selem, andaj I dërguari ka thënë: “E keni shkatërruar! Sepse, sikur ta kishte dëgjuar lavdërimin, kurrë s’do të kishte shpëtuar”.

Pikësëpari duhet të jesh sundues i vetvetes, ta mbash të lidhur gjuhën tënde dhe të mos lëshohesh pas lakmive trupore.

Kafshës së tërbuar nuk i nevojitet litari lidhës më shumë se nefsiti (epshit) tënd.

Njeri, s’mund ta ndërrosh afatin e përcaktuar, e as ta humbish fatin tënd, e as t’ia marrish fatin tjetërkujt. Pse atëherë e mundon dhe e mbyt shpirtin?!

Më i mirë është mesi i artë në të gjitha. Njeriu gjithnjë gjendet ndërmjet tri gjërave:

- sprovës e cila vjen
- të mirës e cila kalon dhe
- vdekjes e cila i merr të gjitha.

Kush nuk është vënë në provë, është mashtruar.

Kush ka luftuar kundër të vërtetës, ka humbur.

Njeriu gjithnjë është në shënjestër të: i sprovave, fatkeqësive ose vdekjes.

Njeri, përgatit të mira apo diç tjetër, por dije se do ta gjeshë vetëm atë që e ke përgatitur. Ndërsa vono ç’të duash, por dije se nuk ka kthim edhe pse do të lutesh që të kthehesh në këtë botë.

Kush e mban mend çastin e fundit, le të mos e lëshojë shtëpinë e vet.

Ç’është kjo?! Ndiej shushullimën, mikun nuk e shoh?!

Kush e kritikon veten para njerëzve – lavdërohet; ndërsa keq është kjo që vepron.

Po të mos ishin bujarët, toka do të çahet; po të mos ishin të mirët, do të dështonte i tërë populli; po të mos ishin të diturit, njerëzit do të ishin si kafshët; po të mos ishte era gjithçka do të prishej dhe do të qelbej!

Tre dështimet më të mëdha janë:

- udhëheqësi të cilit i nënshtrohesh, e ai të mashtron,
- fqinji i cili e përhap të keqen tënde, ndërsa e fsheh të mirën tënde, dhe
- varfëria e që shkakton dhembje.

Nëse te fëmija jote vëren diçka që e urrenë, pendohu te All-llahu xh.sh. dhe kërko falje prej Tij, sepse kjo është pjesë e karakterit tënd, respektivisht, mëkati yt të cilin e ke bërë më herët.

Kur ta tregojnë njerëzit diturinë e vet e t'i lënë veprat e veta, kur me gjuhë dahsurojnë e me zemër urrejnë dhe kur t'indërprejnë lidhjet me të afërmit, atëherë All-llahu xh.sh. në ta do ta lëshojë mallkimin e Vet dhe do t'i bëjë të verbër e të shurdhër.

Sprova është dënimi të cilin All-llahu i Lartmadhëruar e dërgon atëherë kur njerëzit gabojnë me qëllim.

Njerëzit do të dënohen nëse nuk janë të kënaqur me All-llahun xh.sh., e ajo pakënaqësi rrjedh nga mosnjohja e plotë e All-llahut të Lartmadhëruar apo nga njohja e pjesërishme e Tij nga ana e njerëzve.

Largimi nga njeriu i marrë është gjest i afrimit ndaj All-llahut të Lartmadhëruar, ndërsa shoqërimi me të mençurin e përforcon besimin.

Ta respektosh besimtarin është pjesë e shërbimit ndaj All-llahut xh.sh., ndërsa ndihma fitohet me luftën kundër shfrenimit dhe mëkatit.

Le të mos jetë delja më e mençur se ti: atë e dëbon britma dhe e kthen shikimi.

E kam dëgjuar Ebu Bekër ibn Abdil-lah el Muzniun duke thënë:
“Bëhuni këmbëngulës në punë, e nëse ju pengon pamundësia,
ruajuni së paku nga mëkatet”!

I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:
“Në këtë botë njerëzve nuk u është dhënë gjë më e mirë se besimi i
fortë dhe shëndeti i mirë. Lutjuni All-llahut xh.sh., që t’ju japë besim
të fortë dhe shëndet në jetë”.

I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, vërtet e ka
thënë të vërtetën e madhe, sepse me bindjen e fortë në fe fitohet
Xhennenti, ndësa largohet nga Xhehennemi. Kush posedon iman të
fortë, është durimtar në fatkeqësi dhe pakënaqësi, ndërsa aktiv në
veprat fetare. Ndërsa në shëndet është e mira e madhe.

Besimtari nuk dëfrehet e të bëhet i pakujdesshëm. Ai gjithnjë
mendon andaj është i brengusur e i pikëlluar.

Atë që namazi i vet nuk e largon na veprat e këqija, e largon
nga All-llahu xh.sh., dhe e ndjell hidhërimin e Tij në vete.

Ai që kujdeset për veprat e veta është si luftëtari në luftë,
vetëm se (ky i fundit) e ka shpërblimin më të madh e më të mirë.

O njeri, e konsideron të lejuar atë që është e ndaluar, bën
dhunë e mëkat duke u mashtruar me shpresa të kota se do të të falë
All-llahu! Do ta dish se kush ka qenë mëkatar atë Ditë kur nuk do të
të ndihmojnë as pasuria e as djemtë (fëmijët), por vetëm zemra e
pastër.

Të mos bësh mëkat është më mirë se të pendohesh.

O njeri, ç’ndodh me ty! Bën mëkate dhe vepra të këqija, ndërsa
para teje është vepra e mirë të cilën po ashtu mund ta bësh.

O njeri, ruaju mëkateve të mëdha e do të jeshë gjithnjë në të
mira. Mëkati do ta ndryshojë zemrën, ajo do të bëhet e zezë dhe do
ta shkatërrojë të mirën tënde.

Të mrekullueshëm kanë qenë njerëzit e së vërtetës, kur shkopi i
Omerit ka qenë më i respektuar se shpata e Haxhxhaxhit.

Në Ditën e Gjykimit më së shumti do të kërkojë ndihmë njeriu të cilit All-llahu i Lartmadhëruar ia ka dhënë të mirën e Vet, e ai është shërbyer me të në mëkatet ndaj Tij.

Besimtari gjithnjë mbetet i njëjtë, pa marrë parasysh kohën apo situatën. Ai mbetet i pathyeshëm në besim, me një fytyrë të njëjtë dhe në të njëjtën rrugë. Ndërsa dyfytyrëshi ndryshon sipas kohës dhe rastit, duke e shikuar vetëm dobinë e vet duke mos çarë kokën për askë tjetër.

Praktika e besimtarit e vërteton autenticitetin e fjalëve të tij, jeta e tij publike e vërteton jetën private, ndërsa prania e tij e zbulon papranueshmërinë e tij.

Tre persona assesi nuk mund të arsyetohen:

- Ta përgojosh vëllain është njëlloj sikur të ushqehesh me mishin e tij pasi që ka vdekur.

- Njeriu që bën mëkate publikisht, me qëllim që të tregohet në shfrenueshmërinë e tij;

- Bidatçiu, kur tregohet risia e tij, dhe sunduesi tiran, kur i tërhiqet vërejtja për tiraninë e tij.

Katër persona kanë qenë reformatore të vërtetë të cilët e kanë përtërirë jetën dhe e kanë përmirësuar gjendjen e njerëzve në këtë botë, ndërsa dy persona kanë qenë mbjellës të së dyshimtës. Reformatorë janë:

- 1) Omer ibn el Hattabi, radijall-llahu anhu, i cili në ditën Es-Sekife, në propozimin e Ensarëve: "Le të jetë sunduesi prej jush e prej nesh", ka thënë: "O Ensarë! A nuk e dini se I dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë se imamët (sunduesit, udhëheqësit) janë nga fisi Kurejsh. Përveç kësaj, ju e dini se Ebu Bekri, me urdhrin e Të dërguarit e ka udhëhequr xhematin! E kush mund të jetë më meritues se ai që të bëhet sundues i muslimanëve?!" Ensarët e kanë kuptuar se ç'dëshironte të thotë Omeri, andaj Ebu Bekri është zgjedhur

halife (sundues). Po të mos ishte Omeri aq i vendosur dhe i mençur në ato çaste, njerëzit nuk do të pajtoheshin në mendime dhe do të ndaheshin rreth zgjedhjes së sunduesit të muslimanëve dhe ashtu do të mbetej deri në Ditën e Gjykimit.

2) Ebu Bekri, radiallahu anhu, kur e ka kërkuar nga muslimanët mendimin për apostatët, kur e kanë këshilluar që nga apostatët ta pranojë namazin e tyre, ndërsa për mosdhënien e zeqatit t'i lërë të qetë, në çka ai është përgjigjur: "Pasha All-llahun, nëse nuk e japin zeqatin të cilin e kanë dhënë gjatë jetës se Të dërguarit të All-llahut, s.a.v.s., me të vërtetë do ta filloj luftën kundër tyre!". Po të mos ishte Ebu Bekri aq energjik, njerëzit do të refuzonin dhënien e zeqatit dhe ashtu do të mbetej deri në Ditën e Gjykimit.

3) Uthman ibn Affan-i, radiallahu anhu, i bashkoi muslimanët duke i tubuar rreth Kur'anit, kur e ka parë se kanoset rreziku nga mospajtimi rreth leximit të disa pjesëve të librit të All-llahut dhe që njëri-tjetrit ta shpallin si pabesimtar për shkak të leximit të ndryshëm. Po të mos kishte vepruar kështu dhe po të mos i kishte tubuar muslimanët rreth **Mus'hafit**, njerëzit do të largoheshin nga e vërteta duke e profanuar Librin e All-llahut dhe ashtu do të mbetej deri në Ditën e Gjykimit.

4) Ali ibn ebi Talibi, radijall-llahu anhu, pas betejës me banorët e Basrës, ka urdhëruar të shpërndahet plaçka e luftës. Kur disa nga ushtarët e tij të habitur e kanë pyetur: "A nuk do të na i ndashë, o sundues i të drejtëve, fëmijët dhe gratë e tyre?!", Aliu, duke e refuzuar kërkesën e tyre, me mençuri ka pyetur: "E kujt, në atë rast, i kishte takuar Aisheja, Nëna e besimtarëve, si dobi luftarake?!"

Prej kësaj mund të nxirret konkludim i mirë: se gratë dhe fëmijët e robëruar në konfliktin ndërmjet muslimanëve nuk njihen si dobi luftarake dhe nuk mund të ndahen... Po të mos vepronte Aliu me aq mençuri, muslimanët nuk do të dinin si të vepronin me fëmijët dhe gratë e robëruara në konfliktin eventual midis tyre.

Ndërsa dy veta që e mbollën farën e dyshimit dhe i shkatërruan njerëzit janë Amr ibn el Asi dhe Mugire ibn Shu'be.

1. Amr ibn el Asi, në kohën e betejës së Sifinit i ka propozuar Muaviut, që ushtarët e tij ta ngrenë Kur'anin në shtizë, kur ishin në prag të humbjes. Kështu erdhi deri te arbitrazhi i turpshëm, pasojat e të cilit do t'i mundojnë muslimanët deri në Ditën e Gjykimit.

2. Mugire ibn Shu'be ka pritur disa ditë kur i ka lajmëruar Muaviu që të vijë menjëherë. Vonesën e vet para Muaviut e ka arsyetuar me fjalët: "E pata filluar një punë mjaft me rëndësi e nuk dëshiroja ta lë të papërfunduar. Punoja në atë që djali yt Jezidi të caktohet halif pas teje". Duke i dëgjuar këto fjalë Muaviu, me plot gëzim tha: "Kthehu te banorët e Kufes dhe përfundoje punën e filluar!" Kur është kthyer, Mugire për Muaviun ka thënë fjalë të cilat kanë lënë përshtypje të thellë te të gjithë të pranishmit. Ata duke i falënderuar kësaj, pasardhësit e Muaviut i kanë pranuar për halife dhe kështu hilafeti ka mbetur trashëgim. Po të mos ndodhte kështu, muslimanët edhe më tutje do të konsultoheshin mes vete rreth zgjedhjes së halifes dhe do ta kishin zgjedhur atë i cili i posedon të gjitha cilësitë e duhura për sundues të muslimanëve dhe ashtu do të mbetej deri në Ditën e Gjykimit.

I dërguari i All-llahut, s.a.v.s, ka thënë: "Do të vijë koha kur furnizimi për jetë do të mund të arrihet vetëm me mëkate. Kur të vijë ajo kohë, kurorëzimi do të jetë i përqeshur ndërsa mosmartesa e lejuar".

Para jush kanë qenë njerëzit të cilët, duke i ndarë të gjitha të mirat e veta që kanë qenë të shumta si kokrrat e rërës, përsëri janë frikësuar se ajo nuk do të jetë e pranuar tek All-llahu xh.sh. dhe që nuk do të mund të shpëtojnë. Ata vërtet, me seriozitet e kanë kuptuar se ku janë.

I pyetur që të thotë diçka për Ali ibn ebi Talibin, radijall-llahu anhu, Hasani është përgjigjur:

- Vall-llahi, ka qenë shigjetë e vërtetë e qëllimeve të All-llahut, njeri shpirtëror i këtij populli në kulmin e madhërisë dhe nderit të tij. Ka qenë farefis i afërt me Të dërguarin e All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, babai i Hasanit e Husejnit radijall-llahu anhum dhe bashkëshorti i Fatimesë së ndershme (bijës së Të dërguarit). Nuk e ka marrë pasurinë e All-llahut pa të drejtë e as nuk është sjellë në

mënyrë jopërfillëse ndaj asnjë urdhri të All-llahut. Kurrë nuk ka ndier mërzi kur ka qenë fjala për të Drejtën e All-llahut. Kur'anit ia ka kushtuar rëndësinë që i takon: e ka ditur se ç'është sipas tij e drejta dhe obligim i tij. Qoftë All-llahu xh.sh. i kënaqur me të dhe e lartësoftë në shkallë të lartë!

Mos u lidh për këtë botë

Pasha All-llahun, nuk i është dhënë dikujtë ndonjë e mirë e kësaj bote të cilën ai nuk e ka konsideruar si sprovë, e që pas kësaj nuk e ka treguar veten me vepra të mira: feja e tij është gjymtuar, ndërsa mendja e trazuar.

Ndërsa nuk ka pasur njeri të cilin e ka ruajtur All-llahu xh.sh. nga kjo botë e ai nuk e ka marrë si të mirë për të, e të mos ketë mbetur ashtu pa vepra të mira dhe mendim të drejtë.

Nuk ka ndonjë musliman që ka qenë i furnizuar ditë për ditë e ai këtë të mos e ketë konsideruar si e mirë për të, e të mos ketë qenë i paaftë në mendime:

I mbaj mend njerëzit që janë sjellë ndaj kësaj bote si ndaj amanetit të dhënë në ruajtje, e në fund ia kanë kthyer pronarëve të vërtetë.

I mbaj mend njerëzit të cilëve u është ofruar kjo botë përplot bukuri, por e kanë refuzuar duke iu frikësuar përgjegjësisë. Vall-llahi, s'ka njeri që e ka fituar këtë botë e të mos e ketë humbur dinjitetin dhe fenë.

Nuk çuditem prej askujt sikur prej njeriut që mendon se dashuria ndaj kësaj bote nuk hyn në mëkatet e mëdha. Pasha Zotin, ta duash këtë botë është njëri ndër mëkatet më të mëdha! A thua nuk kanë lindur të gjitha mëkatet tjera prej kësaj bote?!

A nuk adhurohen idhujt e nuk gabohet ndaj Mëshiruesit vetëm për shkak se për së tepërmi duhet kjo botë dhe për shkak se i robërohet më shumë se gjithkujt tjetër?!

Në Ditën e Gjykimit njerëzit do të ringjallen të zhveshur, përveç atyre që kanë hequr dorë nga kjo botë.

Pasha All-llahun, askush nuk do ta ngritë asnjë (më lart) e të mos e nënçmojë All-llahun në ditën e Gjykimit!

Iblisi i cili është i mallkuar përgjithmonë, kur janë farkuar dinari dhe dirhemi, i ka vënë në kokë edhe njërin edhe tjetrin duke thënë: “Kush ju do juve, është robi im i vërtetë të cilin do të mund ta kthej kah të dua. Kur njerëzit do të fillojnë ta duan këtë botë, atëherë nuk më brengos që mos ndoshta nuk do t’i adhurojnë idhujt dhe nuk do të marrin zotëra tjerë pos Zotit, por se dashuria ndaj kësaj bote do t’i çojë në një shkatërrim edhe më të madh”.

I kemi parë ata, të cilët duke punuar për atë botë, e kanë fituar edhe këtë, por nuk kemi parë dikë, që duke punuar për këtë botë, ta ketë fituar botën tjetër.

All-llahu xh.sh. ia jep njeriut të mirat e kësaj bote duke e lëshuar në vetëmashtrim, ndërsa ia ndalon (ato) prej kujdesit ndaj tij.

Besimari nuk është i përcaktuar vetëm për jetën në këtë botë.

Isai, alejhis-selam, ka thënë: “Kjo botë është arë e Iblisit të cilën ia lëvrojnë ata që jetojnë në të”.

Kush e ka njohur Krijuesin e vet, e ka dashur dhe i ka dhënë përparësi asaj që është tek Ai. Kush e ka njohur këtë botë dhe mashtrimin e asaj, e ka lënë.

Kur e kanë pyetur se a mund të shihet All-llahu xh.sh. me sy edhe në këtë botë, Hasani është përgjigjur negativisht. Ndërsa kur e pyetën se a do të jetë kjo e mundur në botën jetër, ka dhënë përgjigje pohuese. Kur e pyetën pse është kjo kështu, ai tha:

- Sepse kjo botë është kalimtare dhe gjithçka që është në të po ashtu ishte kalimtare. Ajo botë është e amshueshme, andaj është e amshueshme gjithçka që është e saj. Përveç kësaj, është e pamundur të kuptohet e amshueshmja me atë që është e përkohshme, ajo që është pa fillim me atë që e ka fillimin e vet.

Ndërsa në Ditën e Gjykimit All-llahu xh.sh. do t'u japë prej begatisë së Mirësisë së vet robërve të Vet, shikim të përhershëm me të cilin do të mund ta shikojnë.

Omer ibn el Hattabi, radijall-llahu anhu, ka hyrë te I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., dhe e ka gjetur në shtrat të punuar prej shkopinjeve të palmës. Në anën në të cilën ishte i shtrirë vëreheshin gjurmët e litarëve. Duke e parë në këtë gjendje, Omeri zuri të qajë, ndërsa I dërguari i All-llahut e pyeti: "Pse qan, o i biri i Hattabit?". "Si mos të qaj o I dërguari i All-llahut?!" M'u kujtuan mbretërit e Bizantit dhe perandorët e Persisë dhe dëfrimet e tyre. Ti je i Dërguar, i zgjedhuri më i dashur i All-llahut dhe prap flen në shtratin e thurur prej litarëve!"

"A nuk je i kënaqur me atë që ata e kanë këtë botë, ndërsa ne atë botë? - pyeti I dërguari.

"I kënaqur jam, o I dërguari i All-llahut!" - u përgjigj Omeri.

"Unë në këtë botë jam si kalorësi i cili në një ditë të ngrohtë vere kalëron në kalë dhe përnjëherë sheh një dru me hije të rëndë. Ai ulet një çast dhe pushon, pastaj ngrihet dhe e lë hijen." I dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka bërë një jetë të rëndomtë, tejet modeste e të thjeshtë; ka udhëtuar në dhé, dhe shpesh ka përsëritur: "Unë jam vetëm njeri, ha siç han njeriu i rëndomtë".

Në gurë ka mbetur e shënuar: "O njeri, sikur ta shohish atë pjesë të vogël që të ka mbetur nga jeta, të gjitha dëshirat tua do t'i lësh menjëherë mënjanë duke u përpjekur që të bësh sa më shumë vepra të mira. Ashtu do ta kishe lënë lakminë dhe dinakërinë prej frikës nga dënimi i cili do të vijë nesër "kur të rrëshqasin këmbët, kur familja të braktis, i afërmi heq dorë, miku të harron, kur do të kërkosht ndihmë, e kur askush nuk do të përgjigjet".

Të diturit në mesin e të paditurve janë si mjekët në mesin e të sëmurëve.

E kam dëgjuar Haxhaxhaxhin si u fliste banorëve të Basrës: “All-llahu i Urtë ka caktuar që kjo botë të jetë e përkohshme, ndërsa ajo botë të jetë e amshueshme. Ajo që është e amshueshme, nuk do të zhduket, e as nuk do të mbetet pa fund ajo që e ka fundin. Andaj assesi të mos ju mashtrojë ajo që kjo botë është, e ajo ende nuk është, dhe le të jenë shpresat tuaja të përshtatura shkurtësisë së jetës në këtë botë!”

- Sa çudi e madhe! Si ka mundur Haxhaxhaxhi ta kuptojë atë që e ka njohur dhe përsëri të largohet nga e vërteta!

Ndalimi i dyfytërisë

O Zoti im, kush i nënshtrohet më shumë se unë dështimit dhe gabimit, e kush është më dinjitoz për falje dhe durim përveç Teje!

Ti më ke krijuar të dobët, kështu që unë nuk jam në gjendje ta heq dëmtimin prej vetes e as t'ia ofrojë vetes dobinë.

O Zot im, dituria Jote për mua është e amshueshme, caktimit Tënd unë nuk mund t'i shmangem e as t'i kundërshtoj vendimit Tënd.

Me dëshirën Tënde unë të jam përlur, ndërsa ndihma dhe dhuntia janë prej Teje. Kam gabuar ndaj Teje me dijen Tënde; andaj argumenti është Yti. Për hir të betimit tënd për mëshirë, fute frikën në zemrën time – që të më jetë shpresa vetëm në Ty dhe frika vetëm prej Teje.

O Zoti im, që je më i mëshirshmi, mëshiroje Muhammedin-felajmëtarin e fundit, ndërsa mua dhe gjithë besimtarët tjerë na falë. “Më mjafton All-llahu, sa Sundues i mrekullueshëm që është Ai!”

Kur nisej për në rrugë, Hasani bënte këtë dua:

“O Ti që kur të lihet diçka në ruajtje, atë e ruan dhe e kryen në mënyrën më të mirë, po ta lë në ruajtje atë që ëpr mua është e panjohur dhe atë që e njoh: familjen, fëmijët dhe gjithçka që kam; mi ruaj këto, o Ti te i cili deponimet s’dështojnë”.

Në çastet e e brengave dhe dëshpërimit, Hasani thoshte:

- O Ti që e ke ndalur dorën e Ibrahimit kur dëshiroi ta flijonte djalin kurban derisa njëri-tjetrit i rrëfeshin, e djali i tha; “Vepro butësisht, o baba”!, ndërsa Ibrahim i shtoi: “Duro në caktimin e Zotit tonë, o djali im!”

O Ti që ke caktuar që karvani të jetë ndihmë e Jusufit kur është gjetur në një vend të shkretë dhe në fund të pusit, e që më vonë pas robërimit, e caktove për administrues!

O Ti që e ke dëgjuar zërin e Dhen-nunit në tri errësirat!

O Ti që Jakubit a.s. ia ke kthyer të parit dhe dëshpërimin e tij e ke shndërruar në gëzim!

O Ti që e ke mëshiruar lotin e Davudit dhe i cili e ke larguar sëmundjen e Ejubut!

O Ti që e pranon lutjen e të vobekëtit kur të lutet dhe që e nxjerr nga mjerimi atë që të lutet dhe shpreson në Ty!

O Ti që je i vetmi Krijues i vërtetë dhe Zot të cilit i shërbehet!

O Ti që e ndien lutjen pa zë dhe që e largon çdo fatkeqësi! Të lutem bekoje robin dhe peygamberin Tënd të zgjedhur me të cilin je i kënaqur, Muhammedin, familjen dhe shokët e tij! Ndërsa mua më ruaj nga e gjithë ajo që më bën të brengosur dhe prej meje largoje pikëllimin tim. O më i Miri, prej të cilit kërkohet çdo e mirë dhe më i Ndershmi, në të cilin shpresojmë, O më i Mëshirshmi, mëshira e të cilit kërkohet, ma jep të mirën të cilën vetëm Ti je i denjë ta dhurosh! O më i Mëshirshmi! "Më mjafton All-llahu! Sa sundues i mrekullueshëm është Ai!"

Kur hynte në varreza, Hasani thoshte:

- O Zoti im, Sundues i këtyre trupave të kalbur dhe eshtrave të thërrmuara, pronarët e të cilëve janë larguar nga kjo botë duke besuar në Ty dhe duke shpresuar në mëshirën Tënde, dërgoju prej Vetes frymëzim ndërsa prej meje selam! (Për këtë Hasani ka thënë:)

- Kush e thotë këtë dua, për faljen e tij luten të gjithë të vdekurit që nga koha kur All-llahu e krijoi botën e deri në Ditën e Gjykimit.

(Kur e kanë lajmëruar se Haxhaxhaxhi i është kërcënuar rreptë dhe se ka kërkuar t'i paraqitet, Hasani ka thënë:)

- O Ti që e dëgjon lutjen time, o gatishmëria ime gjatë goditjes së fatit, Ti i cili mund ta largosh pikëllimin tim dhe vështirësinë nga unë! Ti që je i mëshirshëm dhe bamirës për mua, O Zoti im dhe Zot i Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit e pasardhësve të tyre, Zot i Musait, Isait, i Muhammedit, Zot i të gjithë njerëzve! Pash (kaptinat e Kur'anit) **Kâf Hâ Jâ Ajn Sad, Ta Ha, Jâ Sin vel – Kur'anil-hakim**, mëshiroje Muhammedin dhe familjen e tij të pastër, ndërsa mua më ruaj nga e keqja (e Haxhaxhaxhit) dhe e keqja e çdo keqbërësi! Më ruaj nga Haxhaxhaxhi dhe suita e tij, ithtarët e tij dhe ushtria e tij! Largoje nga unë, me fuqinë Tënde, përpjekjen e tij, shqetësimin dhe çdo të keqe! Mbyllja rrugën deri te unë, O Sundues i të gjitha botëve!

O Zot, mëshiroje dhe qetësoje zotëriun tonë, Muhammedin, pejgamberin e fundit!

(Në sëmundje Hasani lutej:)

- O Zot, mos më bën prej atyre që kur sëmuren, pendohen, e kur shërohen, përsëri bien në sprova, e kur varfërohen, pikëllohen! O Zot, ma jep kënaqësinë e atij që është i kënaqur me Ty! Më ruaj në këtë jetën time dhe pas vdekjes sime!

(Një ditë për derisa Hasani e mbante hutben e tij, njëri nga të pranishmit ofshau thellë, me ç'rast Hasani tha:)

- O djali i vëllait tim, ç'deshe me këtë? Nëse në këtë ishe i singertë, atëherë vetëm e ke nxjerrë atë që e ke në zemër. Ndërsa nëse nuk ke qenë i singertë, atëherë e ke shkatërruar shpirtin tënd.

Njerëzit janë përpjekur mjaft me lutjet e tyre, por zëri i asnjërit nuk është dëgjuar. Në mesin e atyre që kanë jetuar para jush ka patur njerëz që e kanë lexuar tërë Kur'anin, e për këtë as mikun më të afërm nuk e kanë njoftuar. Njerit prej tyre i është thënë:

"Ti vërtet nuk shikon anash gjatë namazit, sa e mrekullueshme është përultësia jote!"

Më këtë rast ai i është përgjigjur:

“O djali i vëllait tim, kush mund të të thotë se ku ka qenë zemra ime!”

Rexha ibu Hajevejh e ka parë një njeri se si pas sabahut shtiret se është i përgjumur, e i ka thënë: “Zgjohu, All-llahu të ruajtë! Le të mos mendojë dikush që kjo është për shkak të pagjumësisë sate dhe namazit, e të të humbet vepra”!

Dikush i ka thënë Të dërguarit të All-llahut, s.a.v.s:

“O I dërguari i All-llahut, nuk na është e qartë se çka është **nifaku** (dyftyrësia)?!”

“Secili që shtiret në diçka është dyftyrësh”, -u përgjigj I dërguari.

(Dyftytrëshi) dëshiron ta mundë caktimin e All-llahut mbi veten. Ai te All-llahu është mëkatar i urrejtur. Ai dëshiron që me këtë t’i njoftojë robtë e All-llahut dhe që njerëzit të thonë se është i mirë, ndërsa ai vërtet është shumë larg kësaj. Dituria e All-llahut xh.sh. për atë përpjekje të tij është përherë në zemrat e robërve të Tij.

Më kanë lajmëruar se dikush e ka dëgjuar dikë tjetër se si i lexon fjalët e All-llahut xh.sh.:

“Nuk ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre i Gjithëmëshirshmi do t’u krijojë (në zemrat e tyre) dashuri”.

(Kur’an, 19:96), andaj ka thënë:

“Do t’i bëj ibadet All-llahut xh.sh. në atë mënyrë për të cilën do të flitet në këtë botë”.

Dhe ka filluar rregullisht t’i falë të gjitha namazet dhe të agjërojë duke mos e prishur assesi (agjërimin). Sa herë që e shihnin, ai falej dhe bënte dhikër. Por, sa herë që njerëzit kalonin pranë tij, thoshin: “Sa dyftyrësh i madh që është”. Ato fjalë e nxitën që ta rishqyrtojë edhe një herë me kujdes e tij ibadetin ndaj All-llahut xh.sh., dhe në fund konkludoi kështu: “Sa i shkretë dhe i mjerë që jam! Njerëzit më përmendin për vepra të këqija, ndërsa kjo është për shkak se nuk kam vepruar në emër të All-llahut”!

Pastaj e ka ndryshuar qëllimin e vet dhe përsëri ka filluar të bëjë ibadetet. Por, tash edhe All-llahu e ka ndryshuar qëndrimin e vet ndaj tij ashtu që njerëzit, duke kaluar pranë tij, kanë thënë: “Sa besimtar i mirë, All-llahu e mëshiroftë! Ky është ibadeti i vërtetë”.

Le të jenë veprat tuaja në emër të All-llahut të madhëruar! I dërguari s.a.v.s. ka thënë: “Kush e zbukuron namazin e vet para botës, ndërsa kur është vet nuk është i kujdesshëm, luan me namaz, andaj All-llahu do të luajë me të”, dhe: “Kush u flet njerëzve për veprën e vet, All-llahu do t’i njoftojë krijesat e Veta me të në Ditën e Gjykimit, do ta nënçmojë dhe do ta zvogëlojë veprën e tij”.

o Njeri, si nuk të vjen turp? – flet me fjalët e të devotshmit ndërsa vepron si despot!

o Njeri, vishesh me rrobat e të devotshmit, ndërsa bën një jetë mëkatari! Pohon se ndjek gjurmët e të përkulurve ndaj All-llahut, ndërsa shikon me shikimin e mendjemëdhenjve. Mjer për ty! Nuk e ke asnjë veti të të përkushtuarve të All-llahut! Në Ditën e Gjykimit do të ndalesh para All-llahut i cili “i di shikimet të cilat fshehurazi shikojnë në atë që është e ndaluar dhe në atë që gjoksat e mbulojnë”.

All-llahu xh.sh. do ta shpërblejë me xhennet njeriun të cilit ia pranon vetëm një vepër të mirë. Ndoshta dikush do ta pyesë veten: “Çdo të bëhet me veprat tjera të mira të tij? Duhet ditur se All-llahu xh.sh. i pranon vetëm të mirat që janë bërë në emër të Tij. Prandaj, nëse së paku një vepër e mirë nuk përlyhet me dyfytirësi, njeriu do të jetë i shpëtuar.

Seid ibën Xhubejri e ka parë një njeri i cili duke bërë ibadet është sjellë si i vdekur, andaj i ka thënë: “O vëlla, Islami me të vërtetë është fe e gjallë, andaj le të shihet kjo në veprën tënde! Mos e bën të vdekur, Zoti të vraftë!”

Aisheja, radijall-llahu anha, e ka parë një njeri i cili shtirej si i vdekur dhe ka pyetur për të. Kur i kanë thënë se është prej njerëzve të mirë, ka thënë: “Omeri ka qenë më i mirë se ai, por kur ka ecur, ka nxituar, kur ka goditur, ka goditur me dhembje, kur është ushqyer, e

ka bërë këtë deri në ngopje. Lëreni shtirjen, sepse All-llahu xh.sh. nuk do ta pranojë veprën e atij që shtiret!”

Një njeri i arsimuar në fe ka deklaruar: “Devotshmëria më e mirë është devotshmëria e fshehtë. Një orë e mendimit të thellë tek All-llahu xh.sh. është më e mirë se namazi tërë natën. Nëse në xhema’at është e mira, në vetmi është shpëtimi”.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, ka kaluar pranë Mervan ibni Hakemit i cili ka qenë duke e ndërtuar shtëpinë, andaj i ka thënë: “Nдалu o robi i të Shenjtit! Ndërto fort, shpresoj gjatë, jeto pak dhe ha përtypshëm - në fund është takimi me All-llahun.”

Njerëzit qysh herët janë sprovuar me shpresë të gjatë. Hammad ibën Sel-leme transmeton se Osman en-Nehsheli ka thënë: “I kam përjetuar të njëqind e tridhjetat dhe të gjitha i kam lënë, pos shpresave të cilat çdo ditë më rriten.”

Ebu Derdaja ka thënë: “Tre veta më bëjnë të qeshem ndërsa tre më bëjnë të qaj. Më bën të qeshem:

- Njeriu që shpreson një jetë të gjatë, edhe pse vdekja e kërkon gjithkund.

- Njeriu i cili qeshet shumë, ndërsa nuk e di se a është i kënaqur Krijuesi e Zoti i tij me të apo jo.

- Njeriu i cili është i pakujdesshëm edhe pse e di se nuk do të lihet në pakujdesi.

Ndërsa më bëjnë të qajë:

- Frika nga fundi.

- Ndalja e punës dhe

- Qëndrimi para All-llahut, kur njeriu do të presë që t’ia caktojë All-llahu vendin në Xhennet apo në Xhehennem.

Kush e kritikon veten para botës, ai, në të vërtetë, e lavdëron veten. Andaj kjo nuk është punë e mirë!

All-llahu xh.sh., i ka lënë ndjenjat mes robërve të Vet. Po të mos ishin ato, fëmijët dhe ata të cilët i janë përkushtuar vetëm All-llahut

xh.sh. nuk do të kishin mundur t'i përfitojnë me asgjë në këtë botë.
Ato ndjenja janë: shpresa, afati i caktuar dhe harresa.

Të mësuarit e Kur'anit

Është shënuar se Omer ibën el-Hatabi, radijall-llahu anhu, ka thënë:

“O njerëz, mësojeni Kur'anin duke e kërkuar atë që është tek All-llahu xh.sh., para se ta lexojnë njerëzit duke e kërkuar atë që është në këtë botë.”

Kur njeriu e kërkon diturinë e Kur'anit dhe diturinë në përgjithësi në emër të All-llahut xh.sh., kjo medoemos duhet të shihet në imanin, përlutësinë, devotshmërinë, shpirtmadhësinë dhe thjeshtësinë e tij.

Kur'ani është bar shërimi për besimtarët dhe udhërrëfyes i të devotshëmve. Kush është udhëzuar në bazë të tij, ka fituar, ndërsa kush e ka refuzuar, ka dështuar.

Njerëzit që e lexojnë Kur'anin e nuk veprojnë sipas tij, janë njerëzit më të këqij, sepse nuk e ndjekin rrugën e Kur'anit. All-llahu ka lëshuar mallkim në ta dhe ata i mallkojnë të gjithë ata që e kanë këtë për detyrë.

Para jush njerëzit e kanë lexuar Kur'anin dhe në disa kaptina të tij janë ndalur tërë natën. Kjo është vërejtur në mëngjes në fytyrat e tyre. Sot, kur ju e lexoni Kur'anin, aspak nuk mendoni për porositë e tij, edhe pse e dini se All-llahu për Kur'anin ka thënë: “(Ky është) Libër i begatshëm. Ne ta shpallëm ty këtë, që t'i studiojnë argumentet e tij dhe të marrin mësim prej tij ata që kanë mend.” (Kur'an 38:29)! Pasha All-llahu, në leximin e Kur'anit dhe në ruajtjen e tij nuk hyn vetëm theksimi i saktë i shkronjave të tij duke mos i ruajtur kufijtë të cilët ai i ka caktuar. Ju thoni: “E kemi lexuar Kur'anin dhe nuk e kemi lënë asnjë shkronjë”. Kush thotë kështu, gënjen! Pasha All-llahun, ai njeri e ka lënë të tërin! Ata të cilët e lexojnë

kështu, pasha All-llahun, nuk janë as të ditur, as të njohur, e as të urtë! Kur të flasin ata që e lexojnë Kur'anin të frymëzuar në fjalët e All-llahut: "Ne do të shpallim ty fjalë të rëndë (të madhe)...," (Kur'an, 73:5), ku nënkuptohen puna dhe veprimi sipas Kur'anit, dhe në bazë të fjalëve të All-llahut: "E kur ta lexojmë ty, t'i përcille me të dëgjuar leximin e tij..." (Kur'an, 75-18), zgjedhe atë që Kur'ani e lejon dhe ndaloje atë që ai e ndalon.

Ekzistojnë tre lloje të lexuesve të Kur'anit: të parët e marrin për tregti duke e blerë me të atë që është te njerëzit; të dytët e lexojnë duke i theksuar saktësisht shkronjat e tij, por duke mos i respektuar kufijtë e tij. Ata me leximin e Kur'anit i mbledhin paratë e guvernantit dhe fitojnë pozitë të privilegjuar midis njerëzve. Numri i tyre sot është shtuar dukshëm, All-llahu i largoftë nga kjo tokë; të tretët e lexojnë Kur'anin duke menduar thellë për porositë e Tij. Për ta Kur'ani është bar shërimi.

(Hasan Basriu i ka lexuar fjalët e All-llahut: "Ai është që bëri natën e ditën zëvendësuese të njëra-tjetrës dhe për atë që dëshiron të mendojë apo të falënderojë, argument". (Kur'an, 25:62), dhe tha:

-Subhanall-llah! Si është e pakufishme mëshira e All-llahut , mirësia e Tij e shtrirë çdokund, ndërsa vepra e Tij e mrekullueshme! All-llahu xh.sh. ia ka dhënë natën atij që këtë nuk e ka arritur gjatë ditës, ndërsa ditën atij të cilin nata e ka mashtruar.

E ka lexuar: "...ndërsa për durimin që e patën u plotësua fjala më e mirë (peremtimi i vërtetë) e Zotit, ndaj beni Israilë've rrënuan atë që bënte faraoni dhe populli i tij, si dhe atë që kishin ndërtuar ata..." (Kur'an, 7:137), andaj ka thënë:

- Sa i çuditshëm është njeriu i cili beson në këtë ajet dhe përsëri i frikësohet sunduesit apo tiranit! Pasha All-llahun xh.sh. sikur njerëzit të duronin në sprova, ashtu siç kërkon All-llahu xhel-eshanuhu prej tyre, Ai sigurisht do t'i shpëtonte nga ato. Por ata i frikohen shpatës dhe në frikë dorëzohen plotësisht. I lutemi All-

llahut të Lartmadhëruar të na shpëtojë dhe të na ruajë nga sprovat e rënda”.

E ka lexuar ajetin: “Zjarri do t’ua djegë atyre fytyrat dhe do të duken shumë të shëmtuar brenda tij!”. (Kur’an, 23:104) dhe ka thënë:

- O robër të All-llahut, sa pamje e llahtarshme dhe e tmerrshme është kjo, prandaj mundohuni që të ikni prej saj.

E ka lexuar: “Te Ai ngrihen fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë e Ai i pranon”. (“Kur’an, 35:10), dhe ka thënë:

- Kur njeriu e thotë fjalën e mirë dhe bën vepër të mirë, All-llahu e pranon fjalën e mirë me të mirën e tij. Ndërsa kur e thotë fjalën e mirë, kurse bën vepër të keqe, All-llahu xh.sh. për shkak të veprës së keqe të cilën e ka bërë, e refuzon fjalën e tij të mirë.

E ka lexuar: “... sepse Ditën kur do ta përjetojnë atë (dënim) që u është premtuar, atyre do t’u duket sikur nuk kanë jetuar vetëmse një moment të shkurtër të ditës. Dhe me të vërtetë!. A mos shkatërrohet kush përveç popullit të shfrenuar?!”. (Kur’an, 46:35), dhe ka thënë:

Është e vërtetë, pasha All-llahun, se do të jenë të shkatërruar vetëm ata të cilët kanë qenë të shfrenuar, ata të cilët e kanë përfituar këtë botë në mënyrë të ndaluar, e pastaj e kanë shkapërderdhurë shpejt duke shkuar pas lakmive të veta trupore. Por, shumë shpejtë ata do të kuptojnë se në çfarë dështimi kanë arritur.

Ka lexuar: “Agonia e vdekjes do të vijë me atë të vërtetën (i zbulohet çështja e ahiretit), kjo është ajo prej të cilës ka ikur”. (Kur’an: 50:19) dhe ka thënë:

- Njeriu bën vepra të liga në tokë, andaj kur t’i vijë vdekja do të ikë nga ta çojnë këmbët, por assesi nuk do të mund të ikë.

Ka lexuar: “... Ditën kur ta përjetojnë atë, atyre (idhujtarëve) do t’u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj”. (Kur’an, 79-46), dhe ka thënë:

- O njeri, a thua nuk ke mundur të përmbahesh nga mëkatet as sa ka mes mbrëmjes dhe mëngjesit?!

(Ka lexuar: “Edhe ata që kanë ardhur pas tyre thonë: “Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim, dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtje ndaj atyre që besuan; Zoti ynë, Ti je me të vërtetë i Mirë e Mëshirues!” (Kur’an, 59:10), dhe “...ata që kur shpenzojnë, nuk e teprojnë, e as nuk janë dorështrenguar por e mbajnë mesataren e janë të matur”. (Kur’an, 25:67) dhe ka thënë:

- Le t’a mëshirojë All-llahu njeriun i cili fiton në mënyrë të lejueshme dhe ndan me masë prej të fituarës duke dërguar në këtë mënyrë para vetes të mirën e cila do t’i jetë më se e duhur në Ditën e Gjykimit, kur nuk do të ketë asgjë tjetër! Për këtë, All-llahu ju mëshiroftë, ndajeni tepricën e pasurisë suaj atje ku e kanë caktuar All-llahu dhe I dërguari i Tij, sepse ata para jush janë kënaqur me pakicën e vogël (të të mirave), ndërsa me të mirat e veta i kanë riblerë jetat e veta prej All-llahut xh.sh.

(Kur e ka lexuar: “... dhe ata, të cilët japin (sadaka e zeqat) nga ajo që u është dhënë, pse e dinë se do të kthehen te Zoti i tyre, andaj zemrat e tyre i kanë të frikësuar” (Kur’an, 23:60), ka thënë:

- Ata që e bëjnë këtë mirësi dhe shpërndajnë nga të mirat të cilat u janë dhënë duke i dërguar kështu para vetes veprat e mira, janë plot frikë që mos ndoshta as kjo nuk do t’i shpëtojë nga dënimi i All-llahut.

(E ka lexuar: “Vërtet, Ne e krijuam njeriun në vështirësi të njëpasnjëshme”. (Kur’an, 90:4), dhe ka thënë:

- Mjerë për njeriun! All-llahu nuk e ka krijuar asnjë krijesë tjetër prej kësaj bote që të vuajë ashtu siç vuan njeriu.

(E ka lexuar: “... Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e në botën tjetër do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre”. (Kur’an, 16:97) dhe ka thënë:

- Do t’u japë përkulje, ëmbëlsinë e së cilës e ndiejnë në zemrat e veta dhe do t’u japë furnizim për të cilin nuk do t’i dënojë. Pasha

All-llahun, e gjithë jeta e njeriut është e idhët përveç jetës në Xhennet.

(E ka lexuar: "Dhe pyeti ti (o Muhammed) për fshatin që ishte në breg të detit...! (Kur'an, 7:163), dhe ka thënë:)

- Fjala është për peshkun, gjuajtjen e të cilit All-llahu xh.sh. ua ka ndaluar banorëve të tij vetëm një ditë në javë. Ai peshk pikërisht ditën e ndaluar u ka ardhur përreth me të madhe si sprovë dhe kontrollim i bindjes së tyre. Ata ngurruan se a të gjuajnë atë ditë. Megjithatë u larguan nga frika prej dënimit apo devotshmërisë. Por, rrallë ndodh që njeriu të mos bie në mëkate për të cilat fillon të hamendet. Andaj edhe ata vendosën të gjuajnë në ditën e ndaluar dhe e hëngrën atë peshk. Ky, pasha All-llahun, ka qenë ushqimi më i keq, të cilin edhe lukthi nuk ka mundur t'ua tretë lehtë. Dhe një natë, derisa flinin, u thirrën tri herë. Në thirrjen e katërt u është thënë: "O banorët e qytetit". Në këtë thirrje u zgjuan të gjithë: edhe burrat, edhe gratë, edhe fëmijët Pastaj ai zë u tha: "Bëhuni majmunë të urrejtur!" Dhe ata u bënë të tillë.

Pasha All-llahun, shenjtëria e besimtarit i cili është mbytur në mënyrë të padrejtë është më e madhe se All-llahu xh.sh. se shenjtëria e peshkut, gjuajtjen dhe ngrënien e të cilit e pat ndaluar All-llahu xh.sh., por Ai e ka shtyrë afatin e saj deri në Ditën e Kijametit, ndërsa "Kijameti është më i tmerrshëm dhe më i hidhur".

(Ka lexuar: "Ajo do të jetë vetëm një britmë, dhe të gjithë përnjëherë do të shikojnë". (Kur'an, 37:19), dhe ka thënë:)

- O njerëz, ajo do të jetë britmë prej hidhërimit, andaj kush i nënshtrohet All-llahut me të vërtetë, le të ruhet nga hidhërimi i Tij!

(Ka lexuar: "Ja, ky është Xhehennemi të cilin mëkatarët e mohojnë! Ata do të sillen vërdallë ndërmjet atij (zjarrit) dhe ujit që vlon...!" (Kur'an, 55:43-44), dhe ka thënë:)

- O njerëz, çka mendoni për ata të cilët tërë ditën, të gjatë pesëdhjetë mijë vjet, kanë ndenjur dhe kanë pritur që t'u gjykohej, dhe kur u janë thyer qafat prej etjes, urisë dhe frikës, All-llahu i Lartmadhëruar ka urdhëruar, kështu që kanë qenë të hedhur në flakën e Xhehennemit dhe në ujin që vlon?!

O All-llahu im, vetëm Ti jep mbrojtjen dhe te Ti është strehimi i vërtetë! Strehimi është te Ti dhe vetëm Ty mund të të besojmë! Të lutemi na shpëto, me mëshirën Tënde prej dënimit të cilin e jep, O Ti i cili falë shumë!

(Ka lexuar: “.. dhe ata të cilët janë të kujdesshëm gjatë faljes së namazit...!” (Kur’an, 23:2) dhe ka thënë:)

- All-llahu xh.sh. do t’i mëshirojë ata të cilët në zemër kanë qenë të përlulur, të cilët i kanë ulur shikimet e veta dhe i kanë ruajtur vendet e tyre të turpshme, ata që janë larguar nga e ndaluara dhe e kanë arritur atë që mund të arrihet.

(Ka qenë i pyetur për fjalët e All-llahut xh.sh. “Kush vjen me një (punë) të mirë, ai (në Ditën e Gjykimit) shpërblehet dhjetëfish, e kush vjen me (vepër) të keqe, ai ndëshkohet vetëm për të, atyre nuk u bëhet e padrejtë”. (Kur’an, 6:160), në çka është përgjigjur:)

- Kush vjen me **Lâ ilâhe il-llâhu vahdehû lâ sherike lehû ve enne Muhammeden abduhû vë resuluhû** (që do të thotë: Nuk ka Zot përveç All-llahut, të Vetmit, i cili nuk ka shok dhe Muhammedi është rob dhe I dërguari i Tij), sinqerisht, nga zemra, te All-llahu xh.sh.do ta ketë Xhennetin si shpërblim.

(Ka lexuar: “A mund të jetë shpërblimi i veprës së mirë diç tjetër, pos të së mirës?! (Kur’an, 78:40), dhe ka thënë:)

- Atij që thotë: **“Lâ ilâhe il-lall-llâh** (Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut), shpërblim i është Xhenneti.

(E ka lexuar: “... në Ditën kur njeriu (besimtar) shikon se çka i kanë sjellë duart e veta...” (Kur’an, 78:40), dhe ka thënë)

- Bëhet fjalë për besimtarin i cili është i mençur, mendjemprehtë dhe syçelë, i cili e di se e pret takimi me All-llahun e Lartmadhëruar, për çka i dërgon veprat e mira, të cilat, kur t’i gjejë, do ta gëzojnë. Ai takim do të bëhet në Ditën kur jobesimtarët do të

bërtasin: “Ah, sa mirë do të ishte (për mua) sikur të isha dhé!”, (Kur’an, 78:40).

(E ka lexuar: “Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që i punuan, zemrat e tyre ua mbuluan”. (Kur’an, 83:14), dhe ka thënë:)

- Ky është mëkat mbi mëkat derisa zemra të mos bëhet plotësisht e zezë dhe e vdekur.

(Ka lexuar: “Dhe mos u mburr me atë që e jep e të duket shumë!”, (Kur’an, 74:6), dhe ka thënë):

- Mos mendo se je duke punuar shumë vepra (të mira), sepse ti nuk e di se çka prej asaj do të të pranohet e çka do të refuzohet!

(Ka lexuar: “Juve ju preokupoi përpjekja për shtimin (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës) derisa të mos i vizitoni varrezat (të bëheni banorë të tyre, të vdisni)”. (Kur’an, 102-1-2), dhe ka thënë:)

- Ne të gjithë jemi të All-llahut dhe të gjithë i kthehemi All-llahut! Na preokupon e gjithë kjo, pasha All-llahun, por nuk na bien ndër mend zjarri i amshueshëm dhe kënaqësia e amshueshme. Se kështu nuk është mirë, gjithsesi do ta kuptoni! Edhe një herë: Jo, kështu nuk është mirë. Me siguri do ta kuptoni! O njerëz, sikur dikush t’ju kërcënohej me vdekje, askund nuk do të qetësoheshit. Ky është premtimi i All-llahut, premtimi i “Atij i Cili nuk vdes kurrë!”

Biseda dhe korrespondenca

All-llahu xh.sh., e ka marrë premtimin nga sunduesit, komandantët dhe administruesit se nuk do të sundojnë sipas dëshirës së vet, se do t'i frikohen All-llahut e jo njerëzve dhe se me fjalët e All-llahut (me Kur'an) nuk do të bëjnë tregti. Kush prej atyre e mban premtimin e dhënë, ai ka shpëtuar, ndërsa kush nuk e mban, e ka shkatërruar veten.

Mos i shikoni jetën komode dhe rrobat luksoze të sunduesve, por shikoni në mënyrën e përfundimit të tyre, në përfundimin e keq! Kur All-llahu xh.sh. ia dëshiron të mirën një populli, Ai bën që sunduesit e tij të jenë të butë, kurse të ardhurat shtetërore t'i mbledhin bujarët. E kur Ai vendosë për dështimin e një populli, bën që të sundojnë të marrët, ndërsa të ardhurat (kontributet) t'i mbledhin dorështrënguarit (koprracët).

Kam dëgjuar nga disa shokë Të të dërguarit të All-llahut, s.a.v.s., se në parashenjat e Çastit të fundit, në mes tjerash hyn edhe kjo: Para Kijametit, sundues do të jenë pamoralshmit, ministrat gënjeshtarët, komisarët tradhtarë, të diturit të përdhosurit dhe komandantët tiranë.

Unë vërtet frikohem se mos ndoshta ajo kohë është koha jonë.

(Mëkëmbësi u Basrës, En-Nasër ibën Amri, një ditë në praninë e Hasanit ka thënë: "O babai i Seidit, All-llahu xh.sh. e ka krijuar këtë botë, kurse stolitë dhe bukuritë e saj ua ka lejuar robërve të Vet. Kur'an i thotë: "... Hani dhe pini, por mos e teproni, sepse Ai (All-llahu) nuk i do ata që e teprojnë (shkapërderdhin)", (Kur'an, 7:31) dhe "... Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet? Thuaj: Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në Ditën e Kijametit janë të posaçme për ta". (Kur'an, 7:32), në çka Hasani ka thënë:

- O njeri, frikësoju All-llahut për të mirën tënde! Largohu nga dëshirat e kota, sepse ato do të të shkatërrojnë! Dije se askujt nuk i është dhënë ansjë e mirë e kësaj bote apo botës tjetër, vetëm për shkak të dëshirës së tij.

Ekzistojnë dy shtëpi në të cilat jetohet. Kush bën mirë në këtë botë, do ta ketë edhe atë botë, e edhe në këtë botë do ta gjejë atë që i është caktuar. Ndërsa kush e harron shpirtin e vet, e ka humbur edhe këtë edhe botën tjetër. All-llahu xh.sh. e ka zgjedhur Muhammedin s.a.v.s., e ka dërguar me Shpallje për tërë njerëzimin si Të dërguar (pejgamber) nga mëshira e Vet, si dhe për të gjitha krijesat tjera të Tij. Librin të cilin e ka sjellë ai prej All-llahut xh.sh., tregon se All-llahu xh.sh. ia ka caktuar Të dërguarit të Vet afatin në këtë botë, si edhe të gjithë njerëzve tjerë.

Kur'ani thotë: "Ju në Të dërguarin e All-llahut keni shembull të mrekullueshëm". Neve na urdhërohet të marrim çka jep I dërguari, të shkojmë sipas Udhëzimit, të shkojmë rrugës të cilës ka shkuar I dërguari dhe të veprojmë sipas Sunnetit të tij. Çka arrijmë në atë rrugë, e kemi arritur duke iu falënderuar All-llahut xh.sh. i Cili na ka dhuruar mëshirë. Megjithatë ne jemi të obliguar të pendohemi për mëkatet tona dhe të kërkojmë falje nga All-llahu për të gjitha lëshimet, ngase vetëm ajo është dera e shpëtimit. Në dëshirat e kota nuk ka kurrfarë të mire! Nuk ka të mira as te ata që jetojnë vetëm prej shpresave dhe dëshirave të kota... Në kohën e Të dërguarit, i cili ka vepruar dhe jetuar në mesin tonë, njerëzit kanë thënë se e duan All-llahun xh.sh., andaj Ai e ka shpallur ajetin: "Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t'ju dojë, t'ua falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë!" (Kur'an, 3:31). Do të thotë se dashuria ndaj All-llahut xh.sh., vërtetohet me ndjekjen e rrugës së Të dërguarit të Tij në mënyrë të sinqertë. E kush nuk e ndjek rrugën e Të dërguarit të All-llahut, ai gënjen se e do All-llahun xh.sh.

O njeri, frikësoju All-llahut për të mirën tënde. Pasha All-llahun, i kam parë para teje ata që ishin në gjendjen tënde. Edhe ata kanë dalë në minber sikur del edhe ti. Edhe përcjelljet e tyre kanë qenë kolosale, ndërsa rrobat e tyre, prej mendjemadhësisë së tyre të pamatur, u janë zvarritur për toke. Kanë dëshiruar të tregohen të

fortë para botës andaj kanë ndërtuar dhe janë veshur duke bërë gara. Por, një ditë, papritmas janë rrëzuar nga pozitat e veta dhe përnjeherë ka qenë e padobishme e gjithë ajo që e kanë mbledhur me kudjes nga të mirat e kësaj bote. Në fund janë sjellë para Krijuesit dhe Sunduesit të vet, ku u janë treguar veprat e tyre. E mjerë për ta në ditën kur do ta kenë të qartë se vetveten e kanë mashtruar keq! Mjerë për ta edhe në "Ditën kur njeriu do të ikë edhe prej vëllait të vet, edhe prej nënës dhe babait të vet edhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë çdo njeri do të brengoset vetëm për vete".

O mëkëmbës, frikësoju para së gjithash All-llahut xh.sh. sepse qysh tani ti dallohesh nga njerëzit e rrugës së Drejtë dhe rrugës së Sunnetit, si në jetën private ashtu edhe në atë publike. Dalldisesh me dëshirat e kota dhe kërkon çfarëdo arsytimi. Por dije: ekzistojnë dy grupe të njerëzve ata që kërkojnë këtë botë dhe ata që e kërkojnë botën tjetër. Pasha All-llahun, ai që kërkon botën tjetër e ka gjetur dhe është qetësuar, ndërsa ai që e kërkon këtë botë, askund nuk e gjen. Ai është lodhur prej kërkimit të gjatë dhe gati ka dështuar.

Ti ruaju mos të të pikëllojë kërkimi i asaj që kalon e lënia pas dore e të amshuarës, e të bëhesh prej atyre që do të pendohen rëndë. Me të vërtetë është e qëlluar thënia: "Do t'i mjaftojë njeriut tradhtia, që tradhtarëve do t'u jetë komisar dhe që në veprat e tyre të këqija do t'u ndihmojë!" Një njeri të varfër e kanë kritikuar: "Pse nuk shkon te sunduesi të të japë ndonjë të mirë?", në çka ai është përgjigjur: "I lutem All-llahut xh.sh. të më ruajë nga e gjithë ajo që Ai nuk e do! Të vdes si besimtar e pa asgjë më vjen më mirë se të vdes si dyfytirësh e me turp të madh".

Kur Omer ibën Hubejje është emëruar për sundues në Irak, i ka thirrë Hasanin dhe Esh Sha'biun dhe u ka thënë: "All-llahu i Madh ua ka përmirësuar gjendjen! Mua, halifeja Jezid ibën Abdul Meliku ma ka përgatitur librin e rëndë, në zbatimin e të cilit gjendet dështimi im. Frikësohem se nëse i përulem atij, do të më arrijë dënimi i All-llahut, e nëse nuk i përulem, do të më arrijë hidhërimi i Jezidit prej të cilit nuk do të mund të ikë kurrë. Ç'më këshilloni të bëj?" Hasani iu kthye Sha'biut dhe i tha: "Përgjigju njeriut!" I tronditur nga fjalët e sunduesit, Sha'biu filloi të bie në pëlqim me të dhe shpejtë i kreu

fjalët e veta. Sunduesi dëshironte ta dëgjojë edhe mendimin e Hasanit. Pas ngurrimit të gjatë, Hasani tha:

- Unë të them se, pasha All-llahun, të është ofruar zbritja e melekut të ashpër e të vrazhdë të All-llahut, i cili pa kundërshtim i zbaton urdhrat e Tij. Ai do të të rrëmbejë prej pallatit tënd të gjerë dhe do të të fusë në varr të ngushtë e të errët! Atëherë, o sundues, djali i Abdul Melikut nuk do të mund të të ndihmojë! Megjithatë unë shpresoj se ty All-llahu xh.sh. do të të ruajë nga Jezidi, por jam i sigurt se ty Jezidi nuk do të mund të të shpëtojë nga dënimi i All-llahut. Prandaj frikësoju All-llahut. Nënshtrimi ndaj Jezidit mund ta hedhë mbi ty hidhërimin e All-llahut xh.sh. andaj ku do të shkosh pastaj?! Unë vetëm të përkujtoj në atë me çka All-llahu të frikëson kur thotë: “E këtë (ndihmë) për atë që i frikësohet pranisë Sime dhe i frikësohet dënimit Tim”, (Kur’an, 14:14). Nëse i përulesh All-llahut xh.sh., do të shpëtosh nga e keqja e Jezidit, e nëse Jezidit i bëhesh shok në mëkate, All-llahut xh.sh. do të të lërë në duart e Jezidit edhe atëherë kur ai nuk do të mund të të ndihmojë aspak.

Këtu Ibni Hubejje ka filluar të qajë. Më vonë Hasanin e ka shpërblyer begatshëm, kurse Esh-Sha’biun e ka lënë pa dhuratë. Kur është kthyer te dëgjuesit e vet në xhami, Esh-Shabiu ka thënë:

“O njerëz, kush mund t’i japë përparësi All-llahu xh.sh. ndaj krijesave të Tij, le ta bëjë këtë! Ibni Hubejje e ka kërkuar mendimin tim dhe të Hasanit. Pasha All-llahun, Hasani nuk ka ditur asgjë më tepër se unë, por unë u mundova që t’i jap kënaqësi shpirtit të sunduesit, andaj edhe bisedën ia përshtata kësaj. Dëshirova ta fitoj simpatinë e tij, andaj All-llahu më ka dënuar dhe më ka larguar prej mëshirës së Vet. Ndërsa Hasani ka qenë në anën e All-llahut, andaj Ai e ka afruar edhe më shumë pranë Vetes, ndërsa Ibni Hubejje e ka ngritur më lart se mua dhe e ka shpërblyer begatshëm.

(Duke dalë një herë nga Ibni Hubejje, Hasani në derën e tij e ka takuar një grup dijetarësh të cilëve iu drejtua me këto fjalë):

“Çka ju ka shtyrë të pritni këtu, All-llahu mos e shtoftë grupin tuaj! Dëshironi të hyni te këta të zgjedhosur?! Pasha All-llahun, shoqërimi juaj nuk është shoqërim me bamirësit, e as ndëja juaj nuk është ndëjë me të mirët. Andaj, shpërndahuni prej këtu! Dhashtë

Zoti që shpirtërat tuaj të jenë të ndarë nga trupat tuaj dhe mos dhashtë Zoti që në mesin e muslimanëve të ketë të njëjtë si ju! Jeni veshur, i keni shpërvjelur rrobat, i keni rruar flokët dhe e keni vënë surinën me çka jeni bërë grupi më i keq dhe i keni turpëruar të diturit. All-llahu kurrë mos e bashkoftë grupin tuaj! Po të përmbaheshit nga ajo që është te sunduesi, ata do të vinin pas asaj që është te ju. Por ju keni qenë lakmues ndaj asaj që është në duart e tyre, andaj atyre dituria juaj nuk u është më interesante... Mendoj se pikërisht ju jeni ata të cilët All-llahu xh.sh. i ka larguar nga mëshira e Vet.

(Haxhxhaxhi e ka ndërtuar një shtëpi për vete në Vasit dhe e ka ftuar Hasanin ta shikojë. Duke e shikuar ai tha):

- "Falënderimi qoftë për All-llahun! Sunduesit me të vërtetë e shohin veten të fuqishëm, në çka ne çdo ditë mësohemi dhe në shembujt e tyre marrim mësim. Disa prej tyre ngrisin pallate, i stilizojnë shtretërit, i zbukurojnë rrobat dhe e favorizojnë suitën e vet. E pastaj rreth tyre fillojnë të sillen me lakmi mizat dhe të dashuruarit në Zjarr, si dhe ithtarët e këqij me të cilët ata pastaj lavdërohen: "Shikoni çka kam ndërtuar!"

Kemi parë, o i mashtruar! I korruptuar je dhe të gjithëve në qiell u je i neveritshëm, ndërsa ata në Tokë të mallkojnë! E ke ndërtuar shtëpinë kalimtare duke e rrënuar shtëpinë e amshueshme. Ke qenë kryelartë në shtëpinë e mashtrimit, andaj do të jesh i poshtëruar në shtëpinë e gëzimit të amshueshëm! (Pastaj e ka lëshuar shtëpinë e Haxhxhaxhit duke kënduar: All-llahu e ka marrë obligimin prej të diturve që ata sigurisht njerëzve do t'ua shpjegojnë Kur'anin dhe nuk do të fshehin asgjë". Duke dëgjuar gjithë atë që e tha Hasani, Haxhxhaxhi u hidhërua shumë dhe pasi i tuboi banorët e Shamit atyre iu drejtua me fjalët:

"A nuk më qortoi në praninë tuaj derisa heshtnit, o robërit e banorëve të Basrës?!"

Pastaj me urdhrin e Haxhxhaxhit e kanë marrë Hasanin, i cili, duke i lëvizur buzët ka pëshpëritur në vete. Ai e pyeti: "Ndal, o babai i Seidit! A nuk e ke respektuar atë se unë jam sundues, andaj për mua fole ashtu?!"

Në këtë Hasani i është përgjigjur qetë:

- Le të të mëshirojë All-llahu xh.sh. o sundues! Ai që të frikëson me qëllim që të të ruajë, të është më mëshirues dhe të do e të respekton më shumë se ai që të bën lajka duke të bindur se do të jesh i shpëtuar. E, do të shohësh se kënd e ke pasur mik kur ta shohish frikën. Qëllimi im nuk ka qenë ai që ty të ka rënë ndër mend në fillim kur ke dëgjuar çka kam thënë dhe çka mendon tash. Në dorën tënde, tash janë dy mundësi: falja dhe dënimi. Bëre atë që është më e mirë dhe për çka je i denjë dhe mbështetu në All-llahun, i cili të mjafton ty dhe mua. I mrekullueshëm është All-llahu, Krijuesi dhe Sunduesi ynë!

(Haxhxhaxhi u turpërua prej fjalëve të veta dhe duke kërkuar falje nga Hasani, i bëri nderë dhe i dha shpërblim).

(Kur Adijj ibën Erta është caktuar si sundues i Basrës, ka vendosur që sundimin t'ia besojë Hasanit. Duke e dëgjuar këtë, Hasani ka ikur dhe duke u strehuar në një vend të sigurt, sunduesit ia ka lënë këtë porosi:

- Ai që urren diçka, o sundues, nuk është i denjë ta kryejë dhe nuk mund ta kryejë mirë në rast se duhet ta bëjë atë. Ai i cili e bën këtë pa motiv dhe qëllim të vërtetë meriton të mos i ndihmohet. Ke mundësi që në këtë pozitë të cilën ma ofron mua, t'i vëshë njerëzit që janë më të denjë, andaj është më e nevojshme që atyre t'ua besosh amanetin, të cilin ata do ta ruajnë më mirë se unë. Sepse, nuk ka kurrfarë të mire në kërkimin e ndihmës prej atij i cili mendon se nuk e ka obligim ta pranojë amanetin të cilin duan t'ia besojnë. Andaj, o sundues, më liro nga detyra të cilën dëshiron të ma imponosh me dhunë, All-llahu ty të liroftë dhe të dhashtë çdo të mirë për atë që më ke lënë të qetë! All-llahu, me të vërtetë, nuk ua ndalon shpërblimin atyre që punojnë punë të mira...

(Halifi Umer ibën Abdulazizi ka kërkuar prej Hasanit që ta këshillojë. Duke ia plotësuar dëshirën, ai ka thënë:

“O sunduesi i besimtarëve! Ajo që ka qenë – sikur të mos ketë qenë fare, a ajo që do të vijë – sikur të jetë tash! Dije, o sundues i të drejtëve, se është e mrekullueshme shija e asaj që vjen pas durimit,

madje edhe nëse e shijon idhtësinë e atij durimi! Ndërsa, shija e përfundimit të bukur është me e këndshmeja. Pasoja e kënaqjes së lakmive trupore është gjithsesi e idhët dhe ajo medoemos do të arrijë edhe nëse për një moment e shijon kënaqësinë e saj. Ndërkaq rezultati përfundimtar i gjithë kësaj do të jetë i kobshëm për atë që shkon pas epsheve të veta. Dije, o sundues i të besueshmëve, se do të shpëtojë vetëm ai që ruhet nga mëkatet dhe që përkujdeset që ta fitojë shpëtimin në shtëpinë e amshueshme. Ai do ta meritojë edhe mëshirën e All-llahut dhe do të hyjë në Xhennet.

O sundues i besimtarëve! Kjo botë është shtëpi e pabesisë, prej të cilës duhet të kalojmë në shtëpinë e banimit të përhershëm. Ademi a.s. është zbritur në Tokë që të jetojë në të, ashtu që ta vuajë dënimin për gabimin e bërë. Prandaj bëhu i kujdesshëm ndaj kësaj bote! Sepse, edhe të dashruarit në të do të duhet ta lënë. I pasuri në të është varfanjak i vërtetë ndërsa i lumtur është ai i cili nuk i dorëzohet. Këtë botë e ka shijuar ai që ka përvojë dhe mençuri, i cili e ka zbuluar se ajo e poshtëron atë që e vë më lartë se çdo gjë tjetër. Ndërsa atë që ajo e tubon, e ndan prej asaj që e ka mbledhur.

Kjo botë është sikur helmi: e merr ai që nuk e njeh dhe përpiqet t'i afrohet sa më tepër, sepse nuk e di rrezikun e saj, e ajo, pasha All-llahun, atë e mbyt. Andaj, o sundues, bëhu në të sikur ai që i shëron plagët e veta! Nëse duron vetëm pak, do ta arrish atë që është e amshueshme! I mençur është ai që ruhet nga kjo botë dhe që nuk mashtrohet nga bukuritë e saj. Ai e di se bota është si mashtruesi i aftë dhe i rrezikshëm që u afrohet dhe u pispilloset të gjithëve që t'ju pëlqejë lajkatarëve të vet, sikur nusja, në të cilën janë të drejtuar sytë e të gjithëve dhe në të cilën janë të dashuruara të gjitha zemrat. Kjo botë, pasha Atë që me të Vërtetën e ka dërguar Muhammedin s.a.v.s., është vrasës i të dashruarve të vet. Andaj, o sundues i besimtarëve, ruaju që mos të të rrëzojë edhe ty dhe bëhu syçelë të mos devijosh! Bollëku i kësaj bote sjell fatkeqësi dhe sprova të mëdha, ndërsa lidhshmëria për të medoemos të çon në dështim. Dije, o sundues, se premtimet e saj janë shpresë e kotë, kthjelltësia-turbullim, kurse jeta e saj-vështirësi e vërtetë. Do të fitojë vetëm ai që e lë, kurse do të humbë ai që e merr.

I mençur dhe i ditur është ai i cili i frikësohet asaj me çka e frikëson All-llahu xh.sh. dhe është syçelë në atë ku duhet të jetë syçelë, si dhe ai që e ka llogaritur mirë që patjetër do të ndodhë largimi nga shtëpia e përkohshme në të amshueshmen. Në këtë më vonë çdo njeri do të bindet dhe do të besojë.

Kjo botë është, pasha All-llahun, shtëpia në të cilën vuhet dënimi. Kësaj i vardiset vetëm ai i cili nuk ka mend dhe vetëm ai e grumbullon. Me të është i mahnitur vetëm ai që nuk ka dituri. I zgjuar dhe i mençur është ai që me të i shëron plagët e veta duke e duruar idhtësinë e ilaçeve me shpresë për shërim të shpejtë dhe ai që i frikësohet përfundimit të keq.

Kjo botë është ëndërr, ndërsa Ahireti është zhgjëndërr. Ato vetëm vdekja i ndan. Por, njerëzit janë të lëshuar pas ëndrrave të veta të ngatërruara. O sundues i besimtarëve! Unë vetëm të them siç ka thënë një i urtë: “Nëse shpëton nga bota, ke shpëtuar nga çdo fatkeqësi, e nëse nuk mund të nxirresh, nuk mund të të numëroj ndër të shpëtuarit”.

(Kur e ka pranuar librin e Hasanit, Omer ibën Abdul Azizi ka qarë me aq zë, saqë edhe të gjithë të pranishmit i ka bërë të qajnë. Pastaj ka thënë: “Le ta mëshirojë All-llahu xh.sh. Hasanin! Ai gjithnjë na mëson duke kërkuar të jemi syçelë dhe t’i shmangemi moskujdesit. Ai është vaiz i mrekullueshëm, oratorë i fortë dhe i singertë!” Andaj i ka shkruar Hasanit: “Prej teje kam pranuar këshilla dhe udhëzime të dobishme. Ato kanë qenë ilaç për shpirtin. Ti me të vërtetë saktësisht e ke përshkruar këtë botë sepse, në të i mençur është ai që jeton gjithnjë me frikë sikur të kenë vdekur të gjitha qeniet e gjalla qysh moti. Le të jetë paqja në ty si dhe mëshira dhe bekimi i All-llahut!” Ndërsa Hasani kështu i ka interpretuar fjalët e halifes:

- I mrekullueshëm është sunduesi që e flet të vërtetën dhe i pranon këshillat! Me të All-llahu xh.sh. e ka bërë të lumtur bashkësinë e muslimanëve dhe ua ka plotësuar bekimin, si dhe të gjithë banorëve të shtetit islam ua ka dhuruar mëshirën e Vet.

(E pastaj përsëri i ka shkruar halifes:)

- O sundues i besimtarëve, para teje me të vërtetë janë frika më e madhe dhe ndodhia e tmerrshme! Ato do të vijnë, në çka nuk ka dyshim. Vetëm atëherë do ta shohësh se a ke shpëtuar apo ke dështuar. Ruaju, o sundues, që në atë në të cilën të ka bërë All-llah xh.sh. sundues ndërmjet robërve të Vet, të mos bëhesh si ai të cilit sunduesi ia ka besuar një gjë: a ka dhënë në ruajtje thesarët dhe pasurinë e vet, e ai e ka shkapërderdhur pasurinë, kurse thesarët i ka lënë dhe kështu e ka varfëruar edhe atë edhe familjen e tij. Dije se All-llah xh.sh. i ka urdhëruar prijësit të cilët i ka emëruar në pozita në të cilën je ti, që robërit e vet t'i largojnë nga veprat e këqija dhe t'i ndalojnë, andaj nëse sunduesit bëjnë vepra të këqija dhe janë të korruptuar, si do të jetë gjendja atëherë?! Krahas kësaj Ai i ka urdhëruar që t'i dënojnë ata që e kanë merituar. Si do të jetë gjendja nëse sunduesi duhet të dënohet?!

Përkujtohu, o sundues i besimtarëve, kur do të keshë pak ithtarë të Krijuesi dhe Zoti i gjithësisë dhe pak ndihmës në Ditën kur Ai përsëri do të të ringjallë. Prandaj përgatitu për atë takim, për Ditën e frikës më të madhe dhe të pasigurisë!

Dije, o sundues, se ke shtëpi, por jo atë në të cilën banon tash, por atë në të cilën do të banosh gjatë dhe në të cilën miqtë do të të lënë të vetmuar.

Përgatitu mirë për ditën "kur njeriu do të ikë prej vëllait të vet, nënës së vet, babait të vet, shokëve dhe fëmijëve të vet". "Përkujtoje Ditën kur do të ringjallen të gjithë dhe kur do të dalë në dritë ajo që e kanë fshehur në zemër, kur do të zbulohen fshehtësitë, kur do të ndahet libri, libri i cili as mëkatin e vogël e as të madhin nuk do ta lë por të gjitha do t'i numërojë". Puno derisa të kesh kohë, para se të të arrijë vdekja dhe ta ndërprejë çdo punë!

Ruaju, o sundues i besimtarëve, që të mos i gjykosësh njerëzit siç kanë gjykuar jobesimtarët, apo me ta ta ndjekësh rrugën e tiranëve. Të dobtëve mos ua ngarko mendjemëdhenjtë, sepse mendjemëdhenjtë nuk e respektojnë ndaj besimtarëve as marrëveshjen e as përkrahjen. I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., ka thënë: "Kush e emëron për mëkëmbës ndonjë tiran, ose i ndihmon me diçka, e ka hedhur Islamin pas shpine".

Frikësoju All-llahut! Mos i bart mëkatet tua e me to edhe mëkatet e të tjerëve, barrën tënde e me të edhe barrën e të tjerëve! Le të mos mashtrojnë ata që ndihen mirë në vuajtjet tua dhe që kënaqen me të mira në dëmin tënd. Mos e shiko, o sundues, fuqinë tënde sot, por shikoje dobësinë tënde nesër kur do të jesh i kapur dhe i lidhur me litarin e vdekjes dhe kur do të silllesh te Krijuesi dhe Zoti yt në shoqërinë e melekëve dhe të-të dërguarit, kur të gjithë njerëzit të Gjallit dhe të Amshueshmit do të duhen t'i përkulen.

Unë, o sundues i besimtarëve, edhe pse në këshillën time nuk e kam arritur shkallën e të diturive para meje, nuk kam bërë koprraci në dhënien e këshillave duke u ndier në pozitën tënde. Andaj, librit tim jepja vendin që e meriton. Dëgjoje porosinë e tij si ai që dëshiron të përfitojë prej tij. Le ta zbusë idhtësia e ilaçit shpresën në efikasitetin e tij! Le të jetë paqja, mëshira dhe bekimi i All-llahut mbi ty!

(Hasani e ka dëgjuar dikënd si e mallkon Haxhxhaxhin andaj i ka thënë:)

- Mos e bëj këtë, All-llahu të mëshiroftë! Sepse ai është ashtu, çfarë jeni ju! Ne frikohemi nëse Haxhxhaxhi shkarjohet nga posti ose vdes se mos ndoshta me ju do të sundojnë majmunët dhe derrat. I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., ka thënë: “Sunduesit tuaj janë ashtu siç janë veprat tuaja. Çfarë të jeni ju, ashtu do të jenë edhe sunduesit mbi ju”. Kam dëgjuar se dikush i është ankuar një njeriu të mirë për tiraninë e sunduesit, e ky i është përgjigjur: “Vëlla, e kam marrë librin tënd, në të cilin flet se në çfarë gjendje jeni, se jeni nën dhunën e sunduesit. Ai që bën mëkat nuk duhet ta mohojë dënimin. Unë mendoj se gjendja juaj e tashme është vetëm parashenjë e diç më të vështirë që do t’ju ndodhë si pasojë e mëkateve tuaja”.

Kam dëgjuar se Ebu Bekri r.a., duke e mbajtur hutben në minberin e Të dërguarit të All-llahut, a.s.v.s., ka thënë: “O njerëz, e kam dëgjuar Të dërguarin e All-llahut, s.a.v.s., duke thënë se All-llahu e ka shpallur këtë ajet: “Unë jam All-llahu, nuk ka zot tjetër përveç Meje! Unë jam Sundues i të gjithë sunduesve dhe të gjithë ata janë nën sundimin Tim! Kush më përkulet Mua, Unë do t’i bëj sunduesit të mëshirshëm ndaj tij, ndërsa kush shet trimëri para

Meje, atij për hakmarrje do t'i mbeten sunduesit. Për atë mos i lidhni zemrat tuaja për sunduesit, por kthehuni tek Unë dhe tek Unë pendohuni, e do t'i bëj sunduesit të mëshirshëm ndaj jush dhe do t'i bëj shpirtmirë për ju!"

(Në pyetjen e dikujt për Haxhaxhahin, Hasani ka thënë):

- Ai e lexon librin e All-llahut, mban vaz si edhe të zgjedhurit dhe u ndan ushqim të varfërve. Ai e çmon sinqeritetin dhe dënon si tiran... Sa u përket juve, bëni ibadet dhe pendohuni sinqerisht para All-llahut, se ai do t'ju ruajë nga tirania e tij. Dhe ta dini se te All-llahu ka edhe shumë Haxhaxhaxha!

Këshilla dhe fjalë të urta

Predikues është ai që u predikon njerëzve me vepra të veta, e jo vetëm me fjalë.

Kam dëgjuar se njëri nga njerëzit e mirë ka premtuar që kurrë më nuk do të qeshet derisa të mos e dijë se ku e ka vendin, në Xhennet apo në Xhehennem. Dhe, kurrë deri në vdekje nuk ka qeshur me zë të lartë. (Duke kaluar pranë një njeriu i cili qeshej me zë të lartë, Hasani e pyeti):

- Djali im, a e ke lënë pas vetes Urën e Siratit? Pse e tërë kjo qeshje, All-llahu të mëshiroftë?! Dije se puna është më se serioze! (Thuhet se ky më kurrë nuk ka qeshur).

O njerëz, All-llahu xh.sh. e ka bërë muajin e Ramazanit muaj të garimit të robërve të Vet në përulje ndaj Tij dhe në punë të mira. Vetëm kështu mund të fitohet mëshira e All-llahut. Garoni për të mirë, se vetëm ashtu do të hyni në Xhennet! Ata të cilët kanë garuar në të mirë, kanë fituar , e ata të cilët nuk e kanë bërë këtë, kanë humbur. Është çudi si njerëzit qeshin në ditën kur kanë fituar ata të cilët kanë bërë mirë, kurse përtacët kanë humbur. Pasha All-llahun, sikur të ngrihej perdja, ti do ta shihje se si është i zënë bamirësi me të mirat e veta, ndërsa si argëtohet mëkatari me mëkatën e vet! Nuk do të kishit arritur që t'i ndërroni rrobat tuaja e as t'i rregulloni flokët. Nëse jeni të sigurt që përpjekjet tuaja janë pranuar te All-llahu xh.sh., kurse veprat tuaja janë miratuar, atëherë falënderuesit nuk falënderojnë me qeshje, e nëse në këtë nuk jeni fort të sigurt, ashtu nuk veprojnë as ata të cilët i frikësohen vetvetes.

O njeri, zvogëloje qeshjen tënde, sepse qeshja e tepërt e ngrinë dhe e mbytë zemrën, e largon gëzimin e vërtetë, e zvogëlon trimërinë, kurse të ngriturin e bën të poshtëruar.

All-llahu xh.sh. i ka shpallur Isait a.s.: “O Isa, lajë sytë me lot kur të shohësh se të pakujdesshmit qeshin!”

O robër të All-llahut, përveç vdekjes All-llahu xh.sh. nuk ka caktuar afat tjetër për veprat tuaja. Prandaj gjithmonë punoni. Ai thotë: “Dhe adhuroje Zotin tënd deri të vijë ty e vërteta (vdekja)!” (Kur’an, 15:99).

I kamë parë shtatëdhjetë pjesëmarrës të Betejës në Bedër. Po t’i kishit parë, do të thoshit: “Të çmendurit!” Po ta shihnin ata më të mirën tuaj, do të thonin: “Këta nuk kanë kurrfarë të mire!” E po ta shihnin më të keqen tuaj, do të përfundonin: “Këta nuk besojnë në Ditën e dhënies së llogarisë!”

Le ta mëshirojë All-llahu njeriun i cili shikon e pastaj mendon. E kur mendon, merr mësim. Kur merr mësim, kupton dhe duke kuptuar, duron! Sepse, ka pasur njerëz të cilët kanë kuptuar, por kur kanë kuptuar nuk kanë mundur të durojnë, e atëherë frika i ka shkatërruar zemrat e tyre dhe nuk e kanë arritur atë që e kanë kërkuar, e as nuk kanë mundur t’i kthehen asaj që e kanë lënë. Kështu e kanë humbur edhe këtë edhe botën tjetër. Kjo është humbja më e madhe!

O njerëz, unë ju këshilloj, edhe pse aspak nuk jam më i mirë se ju, e as nuk veproj në jetë më mirë se ju. Edhe unë vetes i bëj padrejtësi, sepse nuk zotëroj mbi epshin tim, e as që e shtyj atë në zbatimin e obligimeve ndaj Krijuesit dhe Zotit të tij. Por, sikur besimtari të mos e këshillonte besimtarin tjetër derisa të mos e drejtojë veten, do të humbin udhërrëfyesit, do të zvogëlohej numri i atyre që këshillojnë dhe nuk do të mbetej askush që të thërrasë kah All-llahu xh.sh., dhe në zemrat e njerëzve të mbjellë dashurinë ndaj Tij. E, askush nuk do të ndalte as nga mëkatet. Por, jeta bëhet në shoqërim me të diturit dhe në këshillim me njeri-tjetrin. Për të devotshmit jeta e vërtetë ngërthehet në këtë. Prandaj prezentoni nëpër ndejat ku dëgjohen këshillat dhe ruani ato ndeja ashtu që gjithnjë të mund të ndjehet fjala e këshillimit. Dhe frikësojuni All-llahut xh.sh. ashtu siç u është urdhëruar!” **Vdisni vetëm si muslimanë!**

O njerëz, ju jeni zgjuar, por edhe koha deri në afatin e caktuar është shkurtuar me çka edhe mundësia për veprat tuaja është zvogluar. Vdekja është përmbi ju, kurse Xhehennemi u është ofruar edhe më shumë.

O Njerëz, ju e keni vetëm një shpirt, të cilin nëse e shpëtoni nga dënimi i All-llahut, nuk do ta dëmtojë humbja e shpirtrave të tjerë, e nëse e humbni, nuk do të ketë dobi kurrfarë dobie nga ajo se të tjerët kanë shpëtuar. Prandaj, ruajuni nga zvarritja e punëve të mira, sepse ajo e ka shkatërruar shumicën prej jush. Ju nuk e dini se kur do të udhëtoni, e as nuk e dini se ku po shkoni. All-llahu e mëshiroftë secilin që punon për atë botë, para se ta harxhojnë gjithë furnizimin që Ai ia ka dhënë!

O njerëz, All-llahu xh.sh. ua ka shtrirë fletën e pastër dhe mbi secilin i ka vënë dy melekë të ndershëm, nga një në anën e djathtë dhe një në të majtën, të cilëve vazhdimisht u dikton; kujt dëshiron i jep pak, e kujt dëshiron i jep me bollëk. Ai libër nuk lë **as mëkat të vogël e as të madh, të gjithë i shënon me kujdes. Në të njerëzit do t'i gjejnë të gjitha që i kanë punuar. Zoti yt askujt nuk do t'i bëjë padrejtësi.**

O njeri, ruaju vetëmashttrimin, sepse ti ende nuk je i sigurt se ke shpëtuar nga dënimi i All-llahut; para teje është frika më e madhe dhe ndodhia më e tmerrshme. Në varr do t'ia vësh vetes nën kokë atë që vetë ia ke përgatitur vetes. Nëse ajo është e mirë, edhe ti do të jeshë mirë, e nëse ajo është e keqe, edhe ti do të jeshë keq. Andaj, puno dhe mos zvarrit në atë që është e mirë. Përgatitu sa ka kohë! Ruaju nga zvarritja në këtë. Ti sigurisht do të jesh i pyetur, andaj sa më parë përgatiti përgjigjet e sakta! O njeri, besimtari zgjohet me frikë të perhershme edhe pse është bamirës, ngase si besimtar nuk mund të jetë ndryshe. Ai edhe flen duke u friëksuar edhe pse është bëmirës, sepse si udhëtar nuk mund të jetë ndryshe. Ai gjithnjë është ndërmjet dy frikave: frikës për mëkatet që i ka bërë, ngase nuk e di se çdo të bëjë All-llahu xh.sh. me të, dhe frikës nga vdekja e cila do të vijë e ai nuk e di se në çfarë gjendje do ta gjejë dhe në çfarë sprove All-llahu xh.sh. do ta sprovojë.

Kur i është shpallur Të dërguarit të All-llahut, s.a.v.s.: "...Kushdo që bën keq, do të ndëshkohet me te dhe pos All-llahut, nuk ka për t'i gjetur vetes as mbrojtës e as ndihmës". (Kur'an, 4:123) Ebu Bekri r.a., ka thënë: "Është shpallur grushti vdekjeprues!" E kur këtë e ka thënë ai, të cilit i është garantuar Xhenneti, ç'të thonë të tjerët?! Merrni mësim, o besimtarë, dhe bëhuni gjithmonë të kujdesshëm kështu që të shpëtoni nga dënimi në Ditën e madhe!

Le ta mëshirojë All-llahu xh.sh. njeriun i cili mendon dhe merr mësim, i cili vëzhgon me kujdes dhe gjërat i shikon mirë dhe nefsit të vet ia kufizon lakminë!

O njeri, All-llahu xh.sh. urdhëron që përveç Atij, askujt tjetër të mos i përulemi dhe nënshtrohemi. All-llahu xh.sh. i ndihmon njeriut i cili dëshiron të jetë i përlur. Ai e ka ndaluar mëkatit dhe e ka bërë njeriun të pavarur prej mëkatit. Ai askujt që nuk dëshiron të bëjë mëkat nuk ia ka zgjeruar kufijtë e mëkatit. Transmetohet se All-llahu xh.sh. do t'i thotë Ademit a.s. në Ditën e Gjykimit: "O Adem, ti sot je dëshmitar mes Meje dhe ummetit tënd. Të mirat e atij të cilit edhe për një kokërr e kalojnë të keqen e tij, do ta fus në Xhennet, kështu që të shihet se Unë i dënoj vetëm tiranët".

Në Xhehennem nuk ka asnjë ngushticë, zingjir apo prangë e që në to të mos jetë shkruar emri i të dënuarit dhe se me çka do të dënohet. Çka mendoni, o njerëz, nëse e gjithë kjo gjendet te një njeri?! Frikësojuni All-llahut dhe ruajuni ndëshkimit të Tij ndaj jush.
"E ndëshkimi i All-llahut është më i madhi, sikur ta dinit".

Sikur ta mbante mend dikush nga ju atë që unë e kam mbajtur mend dhe po ta kishte parë brezin e parë të muslimanëve, brezin më të mirë, me të vërtetë do të brengosej deri në fund, sepse do të bindej, se më seriozi mes jush është sikur më joseriozi në mesin e tyre, kurse punëtori juaj si ai që në mesin e tyre kurrë nuk është munduar. Po të isha i kënaqur me vetveten, ende do t'ua jepja këtë këshillë, por, All-llahu e di se me vetveten nuk jam i kënaqur, prandaj nuk më vjen mirë t'i jap këshillë tjetrit.

O njerëz, All-llahu xh.sh. i ka robërit e vet të zgjedhur. Ata janë sikur ai që i ka parë banorët e Xhennetit si kënaqen, kurse banorët e Xhehennemit si vuajnë. Ata punojnë duke u përpjekur ta arrijnë

kënaqësinë që e kanë parë, kurse të largohen sa është e mundur më shumë nga Xhehennemi, zjarri i të cilit do t'i djegë mëkatarrët. Ata në zemër janë të pikëlluar. Ata nuk do të bëjnë asgjë të keqe, sepse shpirtrat u janë të pastër, kurse nevojat të panjohura. Ata kanë duruar pak dhe ashtu e kanë fituar amshimin. Netë të tëra i kalojnë në ibadet e në lutje Krijuesit dhe Zotit të vet, nxitojnë të lirohen nga robërimi ndaj dikujt tjetër dhe derdhen lot duke menduar për All-llahun xh.sh. Ata janë zemërgjerë. Gjatë ditës janë të butë, të ditur, të devotshëm dhe të fshehur, andaj ai i cili nuk është i njoftuar me punët e tyre mendon se ata janë të pasur për shkak të thjeshtësisë, të sëmurë për shkak të frikës, edhe pse në të vërtetë nuk janë të sëmurë, por u kujtohet Xhehennemi dhe e bartin frikën në zemrat e tyre. Pasha All-llahun, ata janë në atë që ua ka lejuar All-llahu xh. sh., druajnë (frikohen) më shumë sesa druani (frikoheni) ju nga ajo që u është ndaluar. Në zemrën e vet e njohin fenë e tyre më mirë se që e shihni ju këtë botë me sytë tuaj. Ata me të vërtetë frikohen më shumë se nuk do t'u pranohen veprat e mira, se që frikoheni ju nga dënimi për veprat e këqija që i bëni. **“Ata janë në anën e All-llahut, e ata që janë në anën e All-llahut sigurisht do të fitojnë”.**

O njeri, assesi mos të të mashtrojnë egërsirat e ashpra rreth teje: djali yt, gruaja yte, shërbëtori yt dhe pasardhësit tu! Djali është sikur luan i cili në çdo mënyrë dëshiron të rrëmbejë gjithçka që është në duart tua. Gruaja leh si lingua dhe tund bishtin. Shërbëtori duke të vjedhur, është si dhëlpër. Ndërsa trashëgimtarëve, pasha All-llahun, më i dashur u është një dirhem i cili pas vdekjes sate u bie në duar, se çdo e mirë e jotja, madje edhe sikur ta liroje robin. Ruaju që veten mos ta ngarkosh me mëkate duke u munduar që ata ta kenë më mirë. Ti mbetesh një kohë të shkurtër në mesin e tyre, e kur të të lëshojnë në varr dhe të lënë vetëm, do t'i ngjyrosin rrobat me të verdhë dhe do të fillojnë t'i bien deficit e të qeshin me të madhe, derisa t'i do të përgjigjesh edhe për atë që ua ke lënë pas veti. Andaj me kohë përgatitu për **Ditën kur çdonjëri do t'i gjejë para vete të mirat që i ka bërë dhe veprat e këqija që i ka punuar. Do të dëshirojë atëherë që mes tij dhe atyre të jetë largësia më e madhe. All-llahu xh.sh. ju përkujton në Vetën sepse All-llahu është mëshirues ndaj robërve të vet.**

O njerëz, kur dikush nga ju ia tërheq vërejtjen dhe e qorton për diçka shokun e vet, ai e pranon qortimin dhe vërejtjen. Por çka bëhet me atë të cilin All-llahu e qorton dhe ia tërheq vërejtjen, kurse ai përsëri vazhdon sikur të mos jetë qortuar?! All-llahu xh.sh. thotë: “A mos u siguruan ata prej ndëshkimit të All-llahut? Nuk sigurohet kush prej frikës së ndëshkimit të All-llahut, pos njerëzve të humbur.” (Kur’an, 7:99).

A nuk i çuditeni atij i cili vetëm argëtohet, flet pa nevojë dhe për gjithçka është i pakujdesshëm, perderisa ai, në realitet, shkon kah Xhenneti apo Xhehennemi, sepse nuk e di në cilin prej tyre e ka vendin?!

Thuhet se I dërguari i All-llahut, s.a.v.s., ka thënë: “Me të vërtetë All-llahu urren të luani derisa të jeni në namaz dhe derisa të agjëroni të bëni diçka që do ta prishë agjërimin, si dhe e urren të qeshurit në varreza.”

I madhëruar është Ai i cili ka dhënë që zemrat e atyre që e kanë njohur, ta shijojnë ëmbëlsinë e përluljes së plotë ndaj Tij dhe kënaqësinë e shërbimit gjatë përmendjes së përhershme të emrit të Tij, Ai i cili zemrat e tyre ua ka mbuluar me Vetveten e tij, ashtu që asgjë nuk u vie më ëmbël se ta thërrasin Atë, asgjë më gëzim se t’i shërbejnë Atij dhe asgjë më lehtë për gjuhët e tyre se sa ta përmendin Atë! **“I madhëruar dhe i lartësuar është All-llahu nga (mushrikët, politeistët e të ngjashmit) ata që flasin!”**

Është shënuar se Omerr ibën El-Hattabi r.a. e ndizte zjarrin dhe, duke ia afruar dorën, thoshte: “Provo o biri i Hattabit, a mund të durosh në zjarrin e Xhehennemit!” Pastaj i drejtohej All-llahut xh.sh. me lutje që ta ruajë nga zjarri i Xhehennemit dhe prej punëve të atyre që punojnë për Xhehennem. E kur Omer ibën El-Hattabi r.a., si njeri të cilit i është premtuar Xhenneti është frikësuar aq shumë, si ju o njerëz mund të jeni kaq të sigurt në shpëtim?!

Çdo ditë që vjen i thotë njeriut: “O njeri, unë jam dita e re dhe do të dëshmoj për atë që ti e punon në mua. Kur njëherë të shkoj nga ti, kurrë nuk do të kthehem. Andaj, përgatit ç’të duash, por dije se do ta gjesh vetëm atë që e ke përgatitur vet, e lë ç’të duash, por dije se kurrë më nuk do të kthehesh në të”.

O njeri, dita jote është mysafiri yt i cili do të të lë, pastaj ose do të të lavdërojë ose do të të kritikojë. Ashtu bën edhe nata.

O njeri, ata që të respektojnë, këtë e bëjnë për shkak se shpirti është në trupin tënd. E kur të dalë shpirti nga trupi, ata do të të lënë dhe, kur në çfarëdo qoftë rasti do të viheshe pra tyre në atë gjendje, ata do të iknin nga ti sikur nga luani.

Vlerësoni njerëzit sipas veprave e jo sipas fjalëve të tyre, sepse All-llahu xh.sh. nuk e ka dhënë asnjë fjalë e të mos ia ketë caktuar veprën si argument. Vetëm vepra e argumenton ose e refuzon të vërtetën e fjalëve të dikujt. E kur të dëgjosh fjalim të mirë, ngadalë me atë që flet, se nëse fjalët e veta i arsyeton në vepër, ai vërtet është njeri i mrekullueshëm. E nëse veprat dallohen nga fjalët, ruaju të mos jesh në asgjë i njëjtë, sepse kështu mashtrohen fatkeqët.

O njeri, a thua a nuk e di se All-llahu xh.sh. ka thënë: "... te Ai ngritet fjala e mirë dhe veprimi i mirë, e Ai i pranon. E ata që përgatisin dredhira të këqia, për ata është një dënim i rëndë dhe dredhia e tyre është e zhdukur." (Kur'an, 35:10)

Shikoni se si fjalës së mirë i duhet vepra e mirë. Andaj punoni duke bërë mirë se do të keni përfundim me të cilin All-llahu është i kënaqur, e edhe ju do të jeni të kënaqur!

Syri i askujt nuk do të lahet në lot nga frikërespekti ndaj All-llahut xh.sh. e të mos i shpëtojë trupi nga zjarri i Xhehennemit. Fytyrën, e cila është lagur me lot prej frikës e respektit ndaj All-llahut xh.sh., nuk do ta godasë kurrfarë mjerimi e as nuk do t'i ndodhë ndonjë poshtërim.

Çdo vepër mund të vlerësohet dhe sipas saj të jepet shpërblimi, përveç lotëve të derdhur prej frikës dhe respektit ndaj All-llahut xh.sh. Për këtë ato do ta zbusin edhe flakën e Xhehennemit aq sa Ai xh.sh. të dëshirojë. Sikur vetëm një njeri të qante sinqerisht për All-llahun, unë do të shpresoja se për shkak të vajit të tij All-llahu xh.sh. do ta mëshirojë tërë popullin e tij.

All-llahu xh.sh. nuk ka kushtëzuar tjetër çmim për diturinë të cilën ia ka dhuruar njeriut, përveç atij të cilin e merr vetë arritja e diturisë. Andaj kush mëson diçka në emër të All-llahut duke kërkuar me të atë që është në Të, ai është në fitim. E kush mëson në emër të dikujt tjetër nuk do t'ia arrijë qëllimit, e as që do ta dërgojë mësimi i arritur te All-llahu.

Sa i mjerë dhe i pafuqishëm është njeriu! I janë të fshehura shkaqet dhe nuk e di kur do t'i vijë vdekja. Tartabiqja e shqetëson, kurse ngulfatja e mbyt. Për çdo ditë i kalon një etapë kah ajo botë dhe e lë banimin në këtë botë. E ndoshta krahas kësaj trimërohet, mburret, bën dhunë dhe shfaq paturpësi.

O njerëz, punoni dhe përgatituni për ditën e vekjes e **All-llahu do ta shohë veprën tuaj, e edhe I dërguari i All-llahut, pastaj do t'i ktheheni përsëri All-llahut të cilit i është e ditur bota e dukshme dhe e padukshme, e All-llahu ju lajmëron për atë që keni vepruar.**

O njerëz, shfrytëzoni shëndetin dhe kohën e lirë duke bërë punë të mira para **“Ditës kur sytë do të mbeten të hapura, dhe kur njerëzit, duke u ngutur, e me koka të ngritura do të shikojnë pa lëvizur, a zemrat do t'u jenë të zbrazëta”.**

O njeri, assesi mos iu frikëso atij që ka pushtet në tokë, sepse edhe ai është rob i Krijuesit tënd! Mos e lakmo pasurinë e atij që e ka, sepse edhe ai e han vetëm furnizimin e Krijuesit tënd! Kurrë mos e xhelozo njeriun në të mirë, sepse ai punon sipas udhëzimit të Krijuesit tënd! Kurrë mos e nënçmo të varfërin, sepse ai është vëllai yt i dashur.

O njeri, kurrë mos nënçmo asgjë nga përlujta ndaj All-llahut, edhe nëse kjo në sytë e tu është një gjë tejet e vogël, sepse Ai pranon edhe sa grimca e të mirës dhe shpërblen për një çast të përlujës. Sikur të mund ta dishë vlerën e saj te Krijuesi, sinqerisht do të gëzohesh. E kurrë, prapë, mos nënçmo asgjë nga mëkatet edhe nëse ato në sytë e tu janë të vogla dhe të parëndësishme, sepse Zoti yt dënon ashpër.

(Me një rast Hasani prezentonte në një tubim në të cilin kishte pleq dhe të rinj. Duke u drejtuar kah të vjetrit, Hasani i pyeti:)

- Ç'bëhet me grunajat kur piquen?

- Korren, – u përgjigjën ata.

Mandej iu drejtua të rinjve dhe u tha:

- Ka mjaft të korra që nuk e kanë arritur korrjen për shkak të dergjes dhe kushteve të vështira klimatike që i kanë shkatërruar! Këtu Hasani ka filluar të qajë duke theksuar: “All-llahu pra, u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë.” (Kur'an, 14:25).

O njeri, vdes vetëm, përsëri vetëm do të ringjallesh dhe vetë do të përgjigjesh për veprat tuaja. Sikur të gjithë njerëzit t'i nënshtroheshin All-llahut xh.sh., e vetëm ti të gabosh ndaj Tij, nënshtrimi i tyre asgjë nuk do të të sillte dobil! Gjithashtu po të gabonin të gjithë njerëzit, e vetëm ti t'i nënshtroheshe All-llahut, gabimet e tyre asgjë nuk do të dëmtonin. O njeri, gabimet tuaja janë vetëm mëkatet tuaja, për të cilat do të dijnë trupi dhe gjaku yt. Nëse ruhesh nga mëkatet, e ke shpëtuar trupin dhe gjakun tënd, e nëse (ruana Zot) vepron ndryshe, atëherë do ta dish çfarë është zjarri i cili nuk shuket, trupi i cili nuk shkatërrohet dhe shpirti i cili nuk vdes.

Njeriu do të jetë në të mirë përderisa i bëhet vetvetës predikues, përderisa mendimin e zbaton në praktikë dhe e përkujton All-llahun xh.sh. e pastaj e kontrollon vetveten dhe derisa Dita e llogarisë përfundimtarëve t'i jetë brenga e vetme. Kurse, do të jetë në të këqija përderisa të zvarritet në punët e mira, të shkojnë pas epsheve trupore, të jetë i pakujdesshëm dhe të entuziazmohet me dëshira të kota.

Është shënuar se Isai a.s. u ka thënë shokëve të vet: “Punoni në emër të All-llahut, e jo për barkun tuaj, sepse zogjtë as nuk mbjellin e as nuk korren, por ngrihen herët në agim, se furnizmi i vetëm u është ai që ua jep All-llahu. Nëse pohoni se barqet tuaja janë më të mëdhenj se gurrmazit i tyre, shikoni egërsirën e cila po ashtu as nuk

mbjell e as nuk korrë, kurse furnizim i vetëm i është ai që ia jep All-llahu”.

Kush bënë istigfar tri herë pas faljes së sabahut (kërkon faljen e gabimeve nga All-llahu), do t’i falen mëkatet edhe nëse është njëri nga ata të cilët kanë ikur nga fusha e luftës.

Është shënuar se I dërguari i All-llahut a.s.v.s. ka thënë: “Pasha All-llahun, në Xhennet do të hyjë vetëm ai që ka qenë i mëshirshëm”.

Shokët e kanë pyetur: “A nuk jemi të gjithë ne të mëshirshëm, o I dërguari i All-llahut”? Në këtë ai iu tha: “Nuk është kjo mëshirë e dikujt nga ju ndaj fëmijës së vet apo dikujt të afërm, por mëshira ndaj gjithë asaj që ka shpirt”. Këtu I dërguari i All-llahut e ka ngritur zërin.

Omer ibën Hattabi r.a. njëherë ka pyetur: “A dëshironi t’ju them se cilët janë njerëzit më të mirë, e cilët janë më të këqijtë”? Dhe kur shokët i janë përgjigjur se dëshirojnë të dëgjojnë, ai ka vazhduar: “Njerëzit më të mirë janë ata, jeta e të cilëve është e gjatë, kurse vepra e mirë, prej të cilëve njeriu i shpreson të mirës, e është i sigurt nga e keqja e tij. Ndërsa, njerëzit më të këqij janë ata jeta e të cilëve është e gjatë, kurse vepra e keqe, prej të cilëve nuk pritet kurrfarë e mire dhe njeriu nuk është i sigurt nga e keqja e tyre”.

Për njeriun është më mirë që ta mësojë një mësim të dobishëm dhe të veprojë sipas tij sesa ta sakrifikojë tërë këtë botë për botën tjetër.

Shpesh drejtohuni zemrës, sepse zemrat ndryshken shpejtë. Bëhuni rigoroz ndaj vetvetes, sepse njeriu ka prirje për të keqen e nëse nuk i frenoni epsheet e trupit, ato do t’ju shpiejnë në një shkatërrim tejet të madh.

(Në pyetjen: Ç’mendon për shefaatin (ndërmjetësimin në Ditën e Gjykimit), Hasani është përgjigjur):

- Shefaati është e vërteta!

Por, All-llahu i Madhëruar thotë: “Ata përpiqen të dalin na zjarri, por s’do të dalin nga ai, ata kanë dënimin të përhershëm”. (Kur’an, 5:37), i tha dikush nga të pranishmit, në çka ai shtoi:

- Vërtet Xhehennemi i ka banorët e vet të cilët nuk do të dalin prej tij, siç thotë i Madhëruari.

(E kush të tillët do t’i fusë në zjarr dhe përsëri do t’i nxjerr prej tij? - sërish pyeti dikush!)

- Ata në këtë botë kanë bërë mëkate për të cilat All-llahu do t’i dënojë por Ai prapë do t’i nxjerrë nga zjarri, sepse në zemrën e tyre kanë bartur besimin në Të, – tha Hasani.

O njerëz, ruani lidhjet farefisnore dhe mos i ndërpreni, se All-llahu xh.sh. thotë: “Dhe kini frikë All-llahun që në emrin e Tij përbetohemi, ruajeni farefisin (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.” (Kur’an, 4:1).

Xhiahadi më i mirë është lufta kundër epsheve tua.

Kush nuk vdes papritur, sëmuret papritur, andaj frikësojuni All-llahut dhe bëhuni të kujdesshëm të mos ju befasojë e papritura e Zotit tuaj!

Dhuntitë e All-llahut xh.sh. janë aq të shumta, saqë pa ndihmën e Tij nuk mund t’i numërojmë. Ndërsa, mëkatet e njeriut janë aq të shumta, saqë askush nuk mund të shpëtojë pa ndihmën dhe faljen e All-llahut.

E kam dëgjuar Bekir ibën Abdilahin kur ka thënë: “All-llahu do ta mëshirojë njeriun i cili ka qenë i fortë, dhe forcën e vet e ka përqëndruar në përluljen ndaj All-llahut xh.sh., e do ta mëshirojë edhe atë i cili ka qenë i dobët ndërsa është ruajtur nga mëkatet”.

Kush gënjen, nuk beson, e kush nuk beson, sigurisht do të jetë në Xhehennem.

Transmetohet se Ibni Omeri ka thënë: “Kur njeriu gënjen, meleku largohet prej tij një mile që t’i ikë erës (së keqe), e cila shfaqet prej saj.

Konsideroje se nuk është gënjeshtër kur njeriu e thotë të pavërtetën, duke ia dëshiruar të mirën vëllait të vet dhe me dëshirë që ta largojë nga ai të keqen, apo t'i pajtojë dy veta.

O njeri, ti i urren njerëzit për shkak të dyshimit (të tyre), kurse harron se edhe ty të duhet bindje e fortë.

- Zinxhirët me të cilët do të jenë të lidhur banorët e Xhehennemit nuk do t'u vihen si laku rreth qafës që t'i paaftësojnë rojat e tij, por që t'i mbajnë të lidhur për fundin kur t'i kaplojë flaka e Xhehennemit. (Pastaj Hasani filloi të qajë dhe tha):

- O Zoti im, kërkoj ndihmë prej Teje nga zjarri i Xhehennemit dhe veprës e cila dërgon në të.

Është shënuar se një njeri i devotshëm e ka parë në ëndërr shokun e vet të cilin e ka pyetur:

- Ç'është kjo që e ke gjetur?

- E kam gjetur atë që ia kemi përgatitur vetes më parë dhe e kemi humbur atë që e kemi lënë pas vetes, – është përgjigjur ai. Andaj, thashë, shkoni plotësisht të vetëdijshëm dhe të bindur!

Njerëzit ia kanë porositur njëri-tjetrit përmbajtjen nga kjo botë me çrast Zuhdi u kanë thënë: “Zuhdi më i madh (përmbajtja nga dynjallëku) është te njeriu, durimin e të cilit nuk e ngadhënjën ajo që është e ndaluar, ndërsa ajo që është e lejuar nuk e ngadhënjën falënderimin e tij”.

Më është transmetuar se Ebu Hazimi ka thënë: “Ne nuk dëshirojmë të vdesim përderisa të mos pendohemi, ndërsa vdesim e nuk pendohemi. Kush prej jush e takon All-llahun xh.sh. si tiran i cili nuk është penduar, Ai do ta hedhë në Xhehennem. Ah, sa vendbanim i tmerrshëm është ai!”

Njëri nga njerëzit e mirë e të dijshtëm ka dëgjuar se si shprehin njerëzit dëshira të ndryshme, andaj ka kërkuar që edhe ai ta shprehë dëshirën e zemrës së vet: “Ku të kishim pasur fat e të mos ishim krijuar. Meqë jemi krijuar, ku të kishim pasur fat e të mos kishim

vdekur. E, kur të vdesim, ku të kishim pasur fat e të mos ringjallehim. E, kur të ringjallemi, ku të kishim pasur fat e të mos përgjigjemi! E pasi që do të përgjigjemi, ku të kishim pasur fat e të mos dënoheshim dhe dënimi të mos na jetë i përhershëm!"

Para jush njerëzit i kanë pasur zemrat më të buta dhe më shumë janë frikësuar për fenë e tyre. Por, feja e juaj sot është më e dobët, kurse zemrat tuaja më të ashpra.

Njeriu do ta lëshojë mëkatin, nëse ai (mëkati) e fut në brenga. Pendimi është çelës i pendimit të vërtetë. Brengosja për mëkatet e veta (të mos bëhen mëkate) është më mirë se bërja e disa veprave të mira. E vërteta është e rëndë, andaj për të vendosin vetëm ata që janë të sigurt në përfundimin e mirë dhe që e kanë njohur. Dhe, kush i shpreson shpërblimit, i frikësohet dënimit.

I kam mbajtur mend njerëzit të cilëve u është ofruar ajo që është e lejuar, e ata e kanë refuzuar duke thënë: "Nuk na duhet, sepse frikësohemi se mos na prish".

Kush nuk e shëron shpirtin e vet nga sëmundja e mëkateve gjatë jetës së vet, është larg asaj që të shërohet, dhe krejtësisht afër pikëllimit në këtë dynja (botë).

Sikur natën ta kaloje në ibadet dhe prej tij të mbeteshe i kërrusur dhe ditën të agjëroje aq sa të të dobësohej trupi, kjo aspak nuk do të sillte dobi nëse në shpirt nuk je i devotshëm.

Asnjë e mirë vullnetare (nafile) nuk barazohet me mirësinë të cilën ua bën prindërve tu, madje as haxhi e as xhihadi.

Omer ibën el Hattabi r.a. ka thënë: "Kujtojeni Xhehennemin, zjarri i të cilit është i vrullshëm, thellësia e madhe, kurse shtyllat e hekurta".

(Sel-leme ibën Amiri tregon: E falëm xhumanë me Hasan Basriun dhe pas namazit u tubuam rreth tij, kurse ai fillon të qajë. E pyetëm pse po qante, kurse ai filloi të qajë edhe më shumë, e pastaj tha):

- E si të mos qaj?! Sikur të paraqitej në dyert e kësaj xhamie njëri nga shokët e Të dërguarit të All-llahut s.a.v.s., te ne prej Islamit nuk do të njihte asgjë, pos Kibles, nga e cila drejtohem në namaz.

Ah, ah,! Dëshirat e kota e kanë shkatërruar botën. Fjalë ka, por vepra nuk ka. Dituri ka, por durim nuk ka. Besimi ekziston, por nuk ka bindje të fortë.

Ç'është kjo? I shoh njerëzit, por nuk e shoh mençurinë, ndiej shushullimen, por mikun nuk e shoh. Kjo botë ka hyrë në fe, e pastaj ka dalë (pej saj). E dinë se ç'është e mirë, por mirë nuk veprojnë. E dinë ç'është e ndaluar, por atë e punojnë. Feja u është vetëm në gjuhë. Nëse e pyet dikënd prej tyre a beson se do të japë llogari për veprat e veta, ai do të përgjigjet se beson. Betohem në Sunduesin e Ditës së Gjykimit se gënjen! Sepse, në edukatën e mirë dhe në cilësitë e besimtarit numërohen: fuqia së bashku me besimin, vendosmëria së bashku me shpirtmirësinë, besimi së bashku me bindjen e fortë, dituria me zemërmirësinë, zemërmirësia me diturinë, mençuria krahas veprimit të sjellshëm, bujaria në varfëri, sjellja me mençuri në pasuri, mëshira ndaj të pashpresëve, bujaria në vendin e duhur dhe drejtësia me këmbëngulje.

Besimtari nuk bën dhunë as ndaj atij i cili e urrenë, e as nuk do të bëjë mëkat duke i ndihmuar atij të cilin e do. Ai nuk përgojon, nuk bën me sy duke e nënçmuar tjetrin, nuk i hulumton të metat e huaja, nuk flet fjalë të kota, nuk dëfrehet e as nuk luan pa qëllim, nuk i bart fjalët e huaja, nuk e kërkon atë që nuk është e tij, nuk e mohon të vërtetën edhe nëse i përket atij, nuk i kalon kufijtë në kërkimin e faljes, nuk hakmerret kur dikujt i ndodh një fatkeqësi, e as nuk gëzohet kur dikush gabon.

Besimtari në namaz është i përulur dhe i penduar dhe nxiton që sa më parë t'i bie në sexhde All-llahut. Fjalët e tij janë ilaçi i tij i vërtetë, durimi është devotshmëria e tij, heshtja-mendimi i vërtetë, kurse shqyrtimi i tij është mësim. Ai shoqërohet me të diturit që të mësojë. Në mesin e tyre hesht që të mos gabojë. Kur flet, flet që të nxjerrë fitim. Kur besimtari e bën një të mirë, gëzohet, e kur gabon, menjëherë kërkon falje. Kur e qorton dikush, ai përsëri e kërkon kënaqësinë e tij. E nëse dikush e qorton dhe e fyen, ai tregohet i

butë. Kur i bëhet e padrejtë, duron dhe vepron me drejtësi. Vetëm te All-llahu xh.sh. kërkon mbrojtje dhe vetëm prej Tij kërkon ndihmë.

Besimtari në mesin e njerëzve është dinjitoz, kurse në vetmi është falënderues ndaj All-llahut. Është i kënaqur me fatin i cili i është dhënë. Gjithnjë falënderon për komoditetin dhe duron në vështirësi. Nëse gjendet në shoqërinë e atyre që e kanë harruar All-llahun, ai e kujton All-llahun, kurse kur gjendet në shoqërinë e atyre të cilët e kujtojnë All-llahun, kërkon falje për mëkatet e veta. Ja, të tillë kanë qenë shokët e Të dërguarit të All-llahut, s.a.v.s., gjatë tërë jetës së tyre. Të tillë kanë qenë edhe të parët tuaj të mirë. Gjendja juaj është ndryshuar ngase ju e keni ndryshuar veprimin tuaj ndaj All-llahut xh.sh.

Pastaj Hasani ka theksuar: "All-llahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ata ta mos e ndryshojnë vetveten e tyre. Po, kur All-llahu vendos ta ndëshkojë një popull, atë nuk ka kush që ta zbrapsë. Ata (njerëzit) nuk kanë mbrojtës tjetër pos Tij", (Kur'an, 13:11). Dhe në fund ka shtuar:

- O Krijuesi ynë, tregoja mëshirën tënde udhëheqësit tonë Muhammedit a.s. dhe familjes të tij fisnike, as'habëve të tij dhe të gjithë besimtarëve! Ndërsa, neve na dhuro siç u ke dhuruar robërve të sinqertë dhe të dashurve Tu të devotshëm. Ti je i Gjithëfuqishëm dhe Ndihmës në të mira. Neve na mjafton All-llahu, Ai është Zot i mrekullueshëm! Falënderimi qoftë vetëm për All-llahun, Krijuesin dhe Sunduesin e botëve!

Përmbajtja

<i>Edukata dhe vlerat morale.....</i>	<i>2</i>
<i>Thënie dhe këshilla të urta.....</i>	<i>14</i>
<i>Mos u lidh për këtë botë</i>	<i>24</i>
<i>Ndalimi i dyftyrësisë.....</i>	<i>28</i>
<i>Të mësuarit e Kur'anit.....</i>	<i>35</i>
<i>Biseda dhe korrespondenca.....</i>	<i>42</i>
<i>Këshilla dhe fjalë të urta.....</i>	<i>53</i>

Botoi
Këshilli i Bashkësisë Islame – Ferizaj

Për botuesin
Sulejman Ef. Roshaj

Titulli i origjinalit
Hasan el-Basri
“Esmu’hasisen ve la era enisen”

Përktheu nga gjuha arabe
Mehmedalia Haxhiq

Shqipëroi nga gjuha boshnjake
Zejnullah Dërguti
Xhevrije Z. Dërguti

Redaktor gjuhësor
Ismail Kokollari

Korrektor
Jusuf Gashi

Redaktor teknik
N.S. Simnica

Ferizaj
1994